REPUBLIKA E SHQIPËRISË

USHTRIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MBROJTJES

Viti i 68-të i botimit Nr. 49 (8250) Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes E premte, 12 dhjetor 2014

PËRFUNDOI KURSI I 6-TË I LARTË PËR SIGURINË DHE MBROJTJEN

Ka përfunduar Kursi i 6-të i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM). Në ceremoninë e organizuar me këtë rast në auditoriumin e Ministrisë së Mbrojtjes mori pjesë: shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, zëvendësministri i Brendshëm, z. Ilirian Mustafaraj, komandanti i KDS i Kosovës, gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandantët e Forcave, drejtorë drejtorish në MM dhe SHP etj. Të pranishëm ishin gjithashtu ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, z. Nicholas Cannon, zv.ambasasdori i Turqisë, z. Sinan Cem, si dhe atashe ushtarakë të akredituar në vendin tonë. Ceremoninë e hapi komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, kolonel Idriz Haxhia, i cili, ndër të tjera vlerësoi KLSM si kurs i një rëndësie shumë të veçantë për vlerat që ai ofron në çështjet e sigurisë...

» faqe 3

Seminar me personelin e BCU-së

Për një konceptim dhe realizim më të mirë të punës në strukturat e BCU-së në FA

» faqe 5

ANTIKORRUPSIONI

Ministria e Mbrojtjes, përparësi luftës kundër korrupsionit

Konferenca Kombëtare mbi Luftën kundër Korrupsionit, Kodheli: Që në fillim të detyrës si ministre e Mbrojtjes, drejtim kryesore ka qenë lufta kundër korrupsionit

» faqe 2

Demontimi

Shqipëria ka kapacitetet teknike dhe njerëzore për realizimin e projekteve të demontimit

Para pak ditësh përfundoi me sukses demontimi i 17 ton municioneve të ardhura nga Mali i Zi. Ishte ky një proces i një rëndësi të veçantë, jo vetëm për faktin se tashmë e kthen Shqipërinë në një qendër të specializuar demontimi në rajon...

» faqe 4

Forca Tokësore

Përzgjidhet nënoficeri më i mirë për vitin 2014

Konkurrimi ishte vërtetë i fortë, ku spikati jo vetëm niveli i lartë i përgatitjes profesionale të pjesëmarrësve, por edhe edhe një shpirt gare i ndershëm dhe i paanshëm. Para pak ditësh, në Komandën e Forcës Tokësore u zhvillua procesi i përzgjedhjes...

» faqe 7



INTERVISTA

Robert Kuqo, një nga emrat legjendë të basketbollit shqiptar

» faqe 8-9

DOSSIER

Rruga historike e FD, një rrugë e mundimshme, por e lavdishme

faqe 10-11

NATO

Përforcimi i axhendës, gratë, paqja dhe siguria

faqe 12

Zhvilloi punimet Konferenca Kombëtare mbi Luftën kundër Korrupsionit

Ministrja Kodheli: Që në fillim të herës, në detyrën e ministres së Mbrojtjes, një nga drejtimet kryesore ka qenë lufta kundër korrupsionit në institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes

Në Konferencën Kombëtare kundër Korrupsionit që u mbajt në Tiranë, organizuar nga OSBE, UNDP, Komisioni Europian dhe Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli mbajti një ligjëratë në të cilën u fokusua në punën dhe arritjet e shënuara në luftën kundër korrupsionit në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura. Fjala e ministres Kodheli u shoqërua edhe me një brifing, ku u pasqyruan masat parandaluese të mara, ndryshimet në kuadrin ligjor, krijimi dhe forcimi i strukturave antikorrupsion, rritja e informimit dhe transparencës, forcimi i masave edukuese dhe ndëshkimore, si dhe arritjet e shënuara në këtë proces.

Fjala e ministres së Mbrojtjes, Mimi Kodheli, në Konferencën Kombëtare mbi Luftën kundër Korrupsionit

Ministria e Mbrojtjes, përparësi luftën kundër korrupsionit

I nderuar Kryeministri Rama.

Të nderuar kolegë, ambasadorë, të ftuar, miq,

Më lejoni të shpreh kënaqësinë time, që marr pjesë në këtë Konferencë Kombëtare. Bashkëbisedime të tilla rrisin jo vetëm efektivitetin e administratës, por dhe e bëjnë atë më të ndërgjegjshme ndaj korrupsionit, një temë tepër delikate dhe sfiduese për çdo shoqëri. Në Shqipëri, dhe ky nuk është një sekret, ky fenomen në vite ka arritur nivele alarmante, ka ulur besimin e qytetarëve në institucionet e shtetit dhe është bërë pengesë për mirëqenien dhe zhvillimin e shoqërisë tonë.

Të nderuar pjesëmarrës,

Që në fillim të herës, në detyrën e ministres së Mbrojtjes, një nga drejtimet kryesore ka qenë lufta kundër korrupsionit në institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes. Ky fenomen kishte denigruar dhe përbaltur imazhin dhe dinjitetin e Forcave të Armatosura dhe të vetë Ministrisë së Mbrojtjes. Që në ditët e para të qeverisjes, premtuam reformë ligjore, si dhe nisëm një përpjekje të pandalshme për të rregulluar strukturat e mbrojtjes me qëllim rritjen e eficensës së tyre.

Premtuam vënien në funksionim të strukturave të Inspektimit dhe Auditit me synim luftën reale ndaj korrupsionit për të realizuar transparencë të plotë në veprimtarinë e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura. Ishim të bindur se përmes profesionalizmit dhe kontrollit në planifikimin, menaxhimin dhe përdorimin e buxhetit, do të ofronim efiçensë në përdorimin e aseteve të Ministrisë së Mbrojtjes, pa harruar edhe transparencën në procedurat e prokurimeve dhe ankandeve.

Në fushën e personelit dhe të informimit, premtuam eleminim të praktikave korruptive në gradime, promovime, rekrutime, pjesëmarrje në misione. Premtuam gjithashtu kualifikime dhe trajnime më cilësore

dhe informim të vazhdueshëm, për të rritur integritetin dhe dinjitetin e personelit ushtarak e civil që punon në Forcat e Armatosura. Në zbatim të objektivave kryesorë të Planit të Veprimit të qeverisë për luftën kundër korrupsionit, Ministria e Mbrojtjes miratoi dhe po zbaton Planin e saj të Veprimit. Ky plan përcakton qartë qasjen tonë dhe masat konkrete në luftën kundër korrupsionit, brenda institucioneve të mbrojtjes. Për të monitoruar realizimin e këtij plan-veprimi, kemi krijuar njësinë antikorrupsion, pranë Drejtorisë së Inspektimit të Përgjithshëm dhe Antikorrupsionit në Ministrinë e Mbrojtjes. Kjo strukturë është dhe pika fokale e Ministrisë së Mbrojtjes për Komitetin Ndërinstitucional që drejtohet nga Koordinatori Kombëtar për Luftën Kundër Korrupsionit.

Gjithashtu janë bërë gjithë ndryshimet kryesore në paketën ligjore, për të krijuar ambientin e përshtatshëm të të gjithë këtij ndryshimi thelbësor. Ligji i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqiperisë, ka vënë tashmë bazat kryesore të këtij ndryshimi të madh. Në proces janë Ligji për Policinë Ushtarake, ai për Disiplinën, si dhe një paketë ndryshimesh ligjore në fushën e prokurimeve ushtarake.

U ndryshuan procedurat dhe aktet që synojnë kufizimin e fuqive individuale në vendimmarrje në të gjitha nivelet. U hartua një rregullore e re për Komisionin e Gradave dhe Karrierën. U bë i mundur tjetërsimi i mënyrës së dhënies së shërbimeve në Qendrën e Personel-Rekrutimit, u bazua në rregullore dhe transparencë rekrutimi i ushtarëve profesionistë dhe në misione, përzgjedhja e ushtarakëve për trajnim dhe arsimim, si dhe procedurat e rekrutimit të oficerëve dhe nënoficerëve.

Gjatë këtyre 15 muajve të parë në krye të Ministrisë së Mbrojtjes, jemi fokusuar shumë në rritjen e transparencës, kontrollit të përdorimit të Forcave të Armatosura dhe fondeve publike. Për këtë qëllim, u ngritën disa grupe kontrolli për të evidentuar rastet e përdorimit të Forcave të Armatosura jashtë misionit të tyre kushtetues, si dhe të shpërdorimit të detyrës apo të fondeve publike. U forcuan strukturat anti-korrupsion, u konsolidua auditimi i brendshëm përmes rritjes së pavarësisë dhe profesionalizmit të tij. Është bërë i mundur informatizimi i shërbimeve financiare, janë prishur skemat potenciale korruptive, nëpërmjet qarkullimit të punonjësve me ekspozim të lartë ndaj korrupsionit. Kemi vënë në zbatim strategji zhvillimi dhe planifikime periodike përkundrejt zgjidhjeve emergjente. Kemi një plan të qartë veprimi antikorrupsion dhe bëjmë në mënyrë periodike rishikim të vazhdueshëm të tij.

Është rritur informimi dhe transparenca në Forcat e Armatosura për sa i përket menaxhimit të personelit, të aseteve, të burimeve financiare, nëpërmjet shtimit të publikimeve në Faqen Zyrtare të MM. Është realizuar rishikimi dhe shtimi i shërbimeve online që mund të ofrohen nga strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes.

Njësia Antikorrupsion dhe strukturat e tjera përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura kanë evidentuar raste të abuzimeve me fondet publike, në shpërdorimin e aseteve (pronat) të FA, shkelje ligjore në procesin e rekrutimit, të emërimeve e gradimeve të personelit ushtarak dhe arsimimin profesional në FA, etj, të cilat u kanë kaluar për ndjekje strukturave kompetente në vend. Më konkretisht janë bërë:

- 17 kallzime penale për "Shpërdorim detyre dhe kontributeve të dhëna nga shteti"
- 24 ish-titullarë të larguar nga detyra
- Zhdëmtim i arkës së shtetit në shumën 221,842,014 lekë
- 8 persona - lirim/pezullim nga detyra
- 204 persona - gjobitje/mbajtje në pagë
- 121 persona - ndalim disiplinor
- 81 persona – vërejtje

Për këtë arsye, dhe siç e kam përmendur edhe më parë, koha e të paprekshmëve ka ikur njëherë e përgjithmonë.

Në një kohë të shkurtër, kemi bërë të mundur më shumë transparencë në buxhetin e mbrojtjes; menaxhim më të mirë të aseteve të mbrojtjes (ku përfshihen pronat); kontroll më të shpeshtë të veprimtarisë të strukturave vartëse të Ministrisë dhe Shtabit të Përgjithshëm; verifikim konsekuent të procedurave te prokurimeve; ankandeve të hapura publike; kontroll sistematik të procedurave të emërimeve dhe gradimeve të personelit ushtarak etj.

Unë jam e sigurt, se në një kohë delikate për sigurinë në zonën euroatlantike, përdorimi efikas i burimeve të mbrojtjes mbart një domethënie të madhe. Të gjithë e dimë se për të arritur një nivel efikas operacional nevojiten kapacitete, pajisje, trajnim e stërvitje, edukim etj, të cilat implikojnë kosto të konsiderueshme financiare në buxhet. Në këtë drejtim, duhet të vazhdojmë të tregojmë gjithmonë gatishmëri dhe transparencë, kundrejt taksapaguesve tanë. Ky është detyrimi ynë institucional, por dhe moral, ndaj tyre.

Edhe njëherë, dëshiroj të falënderoj organizatorët e këtij aktiviteti, OSBE, UNDP, Komisioni Europian dhe ministrin Çuçi dhe të gjithë personat që bënë të mundur organizimin dhe zhvillimin e kësaj konference. Besoj se aktivitete të tilla, ndihmojnë dhe edukojnë punonjësit dhe institucionet që adresojnë këtë plagë. Unë përfitoj nga ky rast, t'iu siguroj se Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, por dhe personalisht, mbetemi plotësisht të angazhuara të mirëpresim aktivitete të tilla, përsëri, në të ardhmen.

Faleminderit!

STAFI

Kryeredaktor: Muharrem **DARDHA**

Gazetarë: Mimoza **GOLIKJA**, Albert **ZHOLI**

Gazetarë: Saimir **ALIJA**, Etleva **SMAÇI**

Graphic Designer: Afërdita **HYSAJ**

ADRESA: **Ministria e Mbrojtjes, Bulevardi "Zhan D'Ark"**

Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen është kursi më i lartë institucional në hierarkinë e arsimimit të FA të RSH

Përfundoi Kursi i 6-të i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen

Gjeneralmajor Bazo vlerësoi kontributin e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes për përgatitjen dhe zhvillimin e këtij kursi prestigjioz për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes

NËNKOLONELE ALDA SULA,
SHEFE E BCU NË KDS

Ka përfunduar Kursi i 6-të i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM). Në ceremoninë e organizuar me këtë rast në auditoriumin e Ministrisë së Mbrojtjes mori pjesë: shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, zëvendësministri i Brendshëm, z. Ilirian Mustafaraj, komandanti i KDS i Kosovës, gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandantët e Forcave, drejtorë drejtorish në MM dhe SHP etj. Të pranishëm ishin gjithashtu ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, z. Nicholas Cannon, zv.ambasasdori i Turqisë, z. Sinan Cem, si dhe atashe ushtarakë të akredituar në vendin tonë.

Ceremoninë e hapi komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, kolonel Idriz Haxhia, i cili, ndër të tjera vlerësoi KLSM si kurs i një rëndësie shumë të veçantë për vlerat që ai ofron në çështjet e sigurisë dhe të bashkëpunimit rajonal. Gjithashtu, kolonel Haxhiaj falënderoi dhe vlerësoi kontributin e vyer të të gjithë lektorëve, në cilësinë e të ftuarve të nderit, në konsolidimin dhe progresin e kursit, ashtu sikundër vlerësoi dimensionin real të dhënë nga pjesëmarrësit e kursit, si ato të vendeve të rajonit, ashtu dhe pjesëmarrësit shqiptarë, përfaqësues të fushave e ekspertizave të ndryshme, duke e konsideruar si një kontribut për Akademinë e Forcave të Armatosura.

Në emër të pjesëmarrësve në Kursin e Lartë përshëndeti kolonel Vasilios Karavelis, përfaqësues i FA të Greqisë. Ai vlerësoi pozitivisht performancën e kursit në gjithë ecurinë e zhvillimit të tij, standardet e larta të institucioneve arsimore ushtarake shqiptare, KDS dhe AFA, që nuk bëjnë dallim nga nivelet e ofruara në shkollat e tjetra të NATO-s. Kolonel Karavelis nuk la pa përmëndur dhe frymën e bashkëpunimit, mirëkuptimit dhe bashkërendimit midis të gjithë pjesëmarrësve në klasë, pavarësisht nga diversiteti kulturor, duke pasur parasysh vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, përfaqësues të të cilëve ishin pjesëmarrës në kurs. "Vlerësojmë faktin që nëpërmjet këtij kursi kemi pasur rastin të takojmë mentalitete të ndryshme, duke promovuar në këtë mënyrë bashkëpunimin rajonal dhe miqësinë midis vendeve tona'', u shpreh koloneli grek Karavelis.

Në përshëndetjen e tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-ë, gjeneralmajor Bazo, pasi falënderoi të diplomuarit për përfundimin me sukses të Kursit të 6 të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, vlerësoi kontributin e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes për përgatitjen dhe zhvillimin e këtij kursi prestigjioz për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes. Gjeneralmajor Bazo vlerësoi "Qendrën Marshall", institucionet e tjera ndërkombëtare të sigurisë për ndihmën dhe mbështetjen e vijueshme që kanë dhënë për ngritjen dhe konsolidimin e KLSM, si dhe angazhimin e të gjithë lektorëve të kursit dhe të ftuarit e nderit. Ai evidentoi edhe njëherë objektin e kursit, atë të kthimit të tij në një kurs prestigjioz e në një forum "par excellence", i cili ofron analiza të thella, debate dhe diskutime, të cilat do të ndihmojnë në të ardhmen vendimmarrësit për çështjet më të rëndësishme që lidhen me strategjinë dhe politikën e mbrojtjes, jo vetëm për çështje rajonale, por edhe më gjerë, ku të gjithë pjesëmarrësit e kursit të ndihen të lirë dhe të kenë mundësinë për të shprehur mendimet dhe opinionet e tyre nëpërmjet parimit "bisedo me mua dhe jo për mua".

Në fund të ceremonisë, u dorëzuan diplomat për të githë pjesëmarrësit që përfunduan me sukses Kursin e 6-të të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen.

Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen është kursi më i lartë institucional në hiearkinë e arsimimit të Forcave të Armatosura të RSH. Ky kurs synon të trajnojë ushtarakë me gradën kolonel/nënkolonel ose civilë ekuivalentë me ta, jo vetëm nga institucionet e Sigurisë dhe Mbrojtjes së vendit tonë, por edhe nga vendet e rajonit, në tre fusha themelore: në shkëmbimin e eksperiencës midis vendeve të rajonit në fushën e sigurisë dhe reformave të mbrojtjes; të eksplorojë rrugët e përbashkëta për zhvillimin dhe prosperitetin e rajonit; të promovojë përpjekjet e përbashkëta në mbështetje të integrimit euroatlantik. Statusi aktual i këtij kursi që prej 1 nëntorit të vitit 2012 është "NATO LISTED", duke synuar në kalimin e nivelit tjetër më të lartë-"NATO SELECTED COURSE".

Kursi i 6-të i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes u zhvillua prej datës 8 shtator deri më 5 dhjetor 2014. Në ktë kurs morën pjesë:

- 15 lektorë dhe "Guest Speakers" nga institucione të ndryshme qeveritare shqiptare, përfshirë lidershipin politik e ushtarak.
- 11 lektorë të huaj në cilësinë e "Guest Speakers" nga bota akademike, ambasadorë dhe atashe, nga institucione ndërkombëtare të mirënjohura për trajtesat në çështjet e sigurisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.
- 14 studentë me background civil e ushtarak me pjesëmarrje nga Greqia, Kosova, Mali i Z, Turqia dhe Shqipëria.

Për realizimin dhe zhvillimin e KLSM -6 në Akademinë e Forcave të Armatosura, krahas kontributit kryesor të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, ka qenë ndihma dhe asistenca e partnerëve ndërkombëtarë, si ai i Institutit për Studimet në Fushën e Mbrojtjes (CASD) në Romë, Itali, Qendrës "George Marshall Center" në Gjermani, Universitetit të Kolorados i SHBA, Instituti i Studimeve Globale në Itali, si dhe institucioneve ndërkombëtare të vendosura në vendin tonë. Këto institucione kanë krijuar kushtet e nevojshme për shndërrimin e plotë të këtij kursi në një kolegj rajonal. Që nga viti 2007 në këtë kurs kanë përfunduar studimet rreth 105 studentë, 67 prej tyre nga Shqipëria dhe 45 vetë nga rreth 13 vende të rajonit. 29 pjesëmarrës të këtij kursi në vite janë nga organizata e institucione të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare të fushës ë sigurisë, ndërsa 70 veta janë personel me background ushtarak.

KURSI I LARTË

Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen është kursi më i lartë institucional në hiearkinë e arsimimit të Forcave të Armatosura të RSH. Ky kurs synon të trajnojë ushtarakë me gradën kolonel/ nënkolonel ose civilë ekuivalentë me ta, jo vetëm nga institucionet e Sigurisë dhe Mbrojtjes së vendit tonë, por edhe nga vendet e rajonit, në tre fusha themelore...

Uzina e Lëndëve Plasëse në Mjekës demonton 17 ton municione të Malit të Zi

Demontimi: Siguri e plotë dhe korrektesë në realizimin e "Projektit Pilot"

Ka përfunduar me sukses të plotë projekti i asgjësimit të 17 ton municioneve të ardhura nga Mali i Zi. Ky projekt ishte rezultat i një marrëveshjeje midis Shqipërisë dhe Malit të Zi dhe u realizua në Uzinën e Lëndëve Plasëse në Mjekës të Elbasanit. Projekti është i një rëndësie të veçantë, pasi i kthen disa uzina ushtarake në vendin tonë në qendra të specializuara demontimi, duke rritur në këtë mënyrë edhe mundësinë për hapjen e vendeve të reja për punë. Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, gjatë inspektimit që bëri në Uzinën e Lëndëve Plasëse (ULP) në Mjekës, u shpreh mjaft optimiste për mundësitë që i ofrohen qeverisë shqiptare me përfundimin e suksesshëm të këtij projekti pilot. Gjatë këtij inspektimi ministrja e Mbrojtjes Kodheli është takuar nga afër me drejtuesit, specialistë e punonjës të kësaj uzinr dhe i ka falënderuar ata për punën e mirë të bërë për realizimin në kohë të këtij projekti. Gjatë zhvillimit të këtij projekti, u realizua asgjësimi i 17 ton municion i ardhur nga Ministria e Mbrojtjes e Malit të Zi, në kuadër të marrëveshjes së nënshkruar për këtë qëllim midis dy palëve. Vlen të theksohet se për zbatimin e këtij projekti nga punonjësit e ULP në Mjekës u ndoqën me shumë rigorozitet rregullat e zbatimit teknik të kushteve dhe normave të sigurisë sipas standardeve të NATO dhe sipas kërkesave të projektit tonë teknologjik, si dhe në përputhje të plotë me planifikimin nga ana jonë.

Intervistë me z. Valdrin Pjetri, drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Aseteve në Ministrinë e Mbrojtjes

Shqipëria ka kapacitetet teknike dhe njerëzore për realizimin e projekteve të demontimit

Kjo na jep mundësinë që të kontribuojmë edhe në rritjen e punësimit në zonat e thella, ku ndodhen këto uzina dhe ku punësimi i popullatës është më i vështirë

Intervistoi
MIMOZA GOLIKJA

Para pak ditësh përfundoi me sukses demontimi i 17 ton municioneve të ardhura nga Mali i Zi. Ishte ky një proces i një rëndësi të veçantë, jo vetëm për faktin se tashmë e kthen Shqipërinë në një qendër të specializuar demontimi në rajon, por sepse rrit njëkohësisht mundësinë për hapjen e vendeve të reja të punës. Procesi u krye në Uzinën e Lëndëve Plasëse në Mjekës të Elbasanit, nën një "Projekt Pilot", në kuadër të një marrëveshjeje midis dy palëve. Për të mësuar diçka më tepër rreth këtij projekti dhe përmbylljes së tij, biseduam me drejtorin e Drejtorisë së Menaxhimit të Aseteve, në Ministrinë e Mbrojtjes, z. Valdrin Pjetri dhe i morëm këtë intervistë për gazetën "Ushria".

Valdrin Pjetri, drejtor i Menaxhimit të Aseteve, në Ministrinë e Mbrojtjes

Sapo ka përfunduar Projekti Pilot për asgjësimin e 17 ton municioneve të ardhura nga Mali i Zi. Donim të dinim për gazetën "Ushtria" diçka më tepër, si filloi ky projekt, kush ishte qëllimi i tij dhe çfarë rëndësie pati?

Vendet e rajonit të Ballkanit, me prejardhje nga koha e Luftës së Ftohtë, disponojnë sasi të konsiderueshme municionesh konvencionale, të cilat:

- Janë të standardeve lindore, në një kohë që të gjitha këto vende aspirojnë për të hyrë në NATO,
- Disponohen në sasi tepër të mëdha, krahasuar me efektivin e ristrukturuar të FA të këtyre vendeve,
- Janë në limitet e afateve të ruajtjes së sigurt ose i kanë tejkaluar këto afate,
- Nuk i përgjigjen më strategjisë së mbrojtjes kolektive të NATO-s.

Me iniciativën e Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH) dhe të vendeve të tjera aleate, janë iniciuar dhe financuar vazhdimisht projekte për reduktimin e këtyre stoqeve me municione. Në krahasim me vendet e tjera të rajonit, Shqipëria e trajtoi me shumë seriozitet këtë problem. Pas vitit 2008 dhe ngjarjes tragjike të Gërdecit, në bazë të një plani shumë të detajuar, të hartuar në bashkëpunim me specialistët amerikanë të CUBIC, u aktivizua industria ushtarake (e ngritur në Shqipëri për prodhimin e armëve dhe municioneve), për çmontimin industrial të municioneve të tepërta (natyrisht duke kryer rikonstruksionet përkatëse), me objektiv eliminimin e plotë të tyre brenda vitit 2016. Në fund të vitit 2013, rezultoi se ky proces kish avancuar shpejt dhe ish realizuar mbi 90% e objektivit. Tashmë shtrohej problemi i ardhshmërisë i kësaj industrie. Në këto rrethana, me iniciativën e DASH (natyrisht në radhë të parë, me përpjekjet e kërkesat tona), u hodh ideja për ta përdorur në vijim industrinë tonë të çmontimit industrial të municioneve për çmilitarizimin e stoqeve të municioneve në rajon dhe më gjerë. Për materializimin e kësaj ideje, DASH i propozoi Ministrisë sonë të Mbrojtjes dhe asaj të Malit të Zi, zhvillimin e një projekti të përbashkët ku pala malazeze do furnizonte municionet e saj stok dhe pala jonë do të kryente çmilitarizimin e plotë industrial të tyre. Financimi i projektit u morr përsipër nga DASH, i cili caktoi gjithashtu agjencinë NSPA të NATO-s, që në bashkëpunim me të dy vendet, të kryente monitorimin dhe certifikimin e procesit.

Qëllimi dhe rëndësia e këtij "Projekti Pilot" është afirmimi ndërkombëtarisht i kapaciteteve dhe mundësive tona për pjesëmarrje në projekte rajonale dhe më gjerë, për asgjësimin industrial të municioneve, duke konfirmuar njëkohësisht se, këto projekte në uzinat tona kryhen në respektim të plotë të standardeve të sigurisë. Nga ana tjetër, kjo na jep mundësinë e shfrytëzimit më tej të investimit të kryer nga ana jonë në këtë sektor dhe ç`është më e rëndësishme, të kontribuojmë në rritjen e punësimit në zonat e thella, ku aktualisht ndodhen këto uzina dhe punësimi i popullatës është më i vështiri.

A kishte një marrëveshje lidhur me fillimin e projektit?

Po, po sigurisht, janë pjesë e procedurës…Për kryerjen e këtij "Projekti Pilot", paraprakisht u nënëshkrua "Marrëveshje teknike, ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Malit të Zi, mbi çmilitarizimin e municioneve, NSPA-Projekti Pilot".

I gjithë procesi i demontimit u krye në Uzinën e Lëndëve Plasëse në Mjekës të Elbasanit. Pse zgjodhët pikërisht këtë uzinë?

Uzina e Lëndëve Plasëse në Mjekës u zgjodh pasi kjo uzinë dispononte projektin teknologjik dhe linjën përkatëse, për asgjësimin industrial të tipit të municionit të përcaktuar në kontratë dhe gjithashtu,kish zbatuar projekte të ngjashme me municionet tona.

Garantohen kushtet teknike në këto projekte, të transportit, të magazinimit apo të ruajtjes, por sigurisht edhe stafi pjesëmarrës gjatë procesit të demontimit. A kryhet ky proces sipas rregullave e standardeve të NATO-s, sidomos duke pasur parasysh përvojën shumë të hidhur të ngjarjeve të Gërdecit.....

Duhet theksuar se me ngjarjen e Gërdecit, në rastin konkret, nuk mund të bëhet asnjë analogji. Çmontimi industrial i municioneve nga industria jonë ushtarake bëhet mbi bazën e projekteve teknologjike, të cilat hartohen dhe miratohen vetëm pasi plotësohen standardet e sigurisë. Në këtë drejtim, vijimisht kemi pasur edhe monitorimin e agjencisë NSPA të NATO-s.

Ju thatë më sipër se financimi i projektit u bë, nga agjencia NSPA e NATO-s, sa ka kushtuar ky projekt, ndoshta një shifër…

Po, siç e përmenda më sipër projekti u financua në kuadrin e fondit të besimit nga DASH, që caktoi agjencinë NSPA të NATO-s, e cila në bashkëpunim me të dy vendet, të kryente monitorimin dhe certifikimin e procesit. Duhet theksuar se projektet e çmontimit industrial të municioneve janë gjithnjë të kushtueshme. Megjithatë për arsye që dihen, kostoja e këtij projekti, krahasuar me informacionet që kemi për të tilla projekte në vendet e BE, rezulton më e vogël, gjë që përbën avantazhin tonë në krahasim me vendet e tjera. Kosto e këtij projekti të kryer vlerësohet në masën 18,640 euro.

Tashmë që ky projekt ka përfunduar me sukses dhe në përputhje të plotë me planifikimin, do të kemi të tjera projekte në të ardhmen?

Suksesi i arritur gjatë kryerjes së këtij Projekti Pilot, siguria e plotë dhe korrektesa në realizimin kohor sipas planifikimit të kryer paraprakisht nga ne dhe kosto e ulët, sigurisht që rrisin mundësitë që në të gjitha projektet rajonale dhe më gjerë oferta e industrisë sonë ushtarake të konsiderohet nga vendet partnere me përparësi. Qellimi kryesor i projektit ishte t'i tregonim vendeve te interesuara se Shqipëria ka kapacitetet teknike dhe njerëzore për kryerjen e projekteve te tilla.

Seminar me personelin e strukturave të BCU-së të Forcave të Armatosura

Për një konceptim dhe realizim më të mirë të punës në strukturat e BCU-së në FA

Në shtypin ushtarak dhe në median sociale të MM lipset një bashkëpunim më i ngushtë me strukturat e BCU-së, nga niveli më i lartë dhe deri tek më i ulëti i tyre

NËNKOLONEL ARIAN OSMANI



Drejtoria e Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, në zbatim të detyrave që rrjedhin nga plani vjetor i punës, zhvilloi një seminar me personelin e strukturave të BCU-së të komandave të Forcave, njësive mbështetëse dhe reparteve të tjera të vartësisë së tyre të FA-së. Qëllimi i këtij takimi ishte njohja dhe vendosja e kontakteve me personelin e BCU-së, sidomos të atyre që janë emëruar në këto detyra sipas strukturës së re që po implementohet në Forcat tona të Armatosura; evidentimi i punës së deritanishme nga këto struktura, si dhe të problematikave që janë konstatuar gjatë kontrolleve apo raportimeve të ndryshme. Takimi u zhvillua në formën e një bashkëbisedimi, ku në mënyrë të lirshme pjesëmarrësit diskutuan dhe shkëmbyen mendime dhe përvojë rreth çështjeve të ndryshme që lidhen me misionin dhe detyrat e tyre, duke evidentuar edhe probleme e mangësi që janë vërjetur në dinamikën e përditëshme të punës.

Takimi u hap nga drejtoresha e Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, kolonel Manushaqe Shehu, e cila pasi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë seminar, u ndal në disa çështje që lidhen me misionin, strukturën, detyrat e strukturave të BCU- në njësi e reparte. Gjithashtu ajo nënvizoi arritjet e deritanishme në punën dhe aktivitetin e përditshëm të personelit të kësaj strukture, si dhe vuri në dukje dhe problemet e dala gjatë aktivitetit të përditshëm, të cilat nuk i përgjigjen si duhet kërkesave të kohës dhe standardeve të NATO-s.

Me fokus të veçantë u trajtua plotësimi i detyrimeve nga ana e Detashmentit të CIMIC, tashmë pjesë e Shkollës së Trupës së Komandës Mbështetëse, në përgjigje të detyrimeve që rrjedhin nga CT 3110, si objektiv i deklaruar në NATO. Në këtë kuadër u shtrua nevoja e rritjes së informacionit për këtë strukturë, pasi një pjesë e mirë e personelit të saj janë të rinj dhe u mungojnë njohuritë e duhura.

Në takim u trajtuan edhe dokumentet më të fundit të NATO-s në fushën e BCU, të tilla si udhëzuesi i Komandës Aleate për Operacionet (ACO), për bashkëpunimin civilo-ushtarak (ACO INTERIM CIVIL-MILITARY COOPERATION FUNCTIONAL PLANNING GUIDE). Ky material i përditësuar, i cili zëvendëson versionin e qershorit 2012, ka për qëllim që të sigurojë udhëzime sa i takon përshkrimit të rolit dhe detyrave të BCU gjatë procesit të planëzimit.

Gjatë brifingut të mbajtur u trajtuan problematika të hasura nga personeli i BCU-së, të cilat janë konstatuar gjatë komunikimit të përditshëm me këto struktura dhe që ndikojnë drejtpërsëdrejti në realizimin me sukses ose mosrealizimin e detyrave që rrjedhin nga misioni i BCU-së. Një analizë e veçantë iu kushtua përfundimeve të nxjerra nga monitorimi i drejtpërdrejtë i rolit dhe detyrave të personelit të BCU gjatë stërvitjeve. Kjo për faktin se gjatë procesit të planëzimit janë vërejtur probleme e mangësi, prandaj dhe u diskutua më konkretisht se si strukturat e BCU-së të realizojnë në terren detyrat dhe misionin e saj në planin e përgjithshëm të operacionit. Pjesë e rëndësishme e seminarit ishte zbatimi me korrektësi i rregullave dhe normave të përcaktuara në udhëzimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së "Mbi procedurat e punës për planëzimin dhe zbatimin e planeve të informimit publik në FARSH", nr. 632, dt. 27.01.2014. Një pikë e veçantë e seminarit, e cila u trajtua gjerësisht, ishte ndërtimi i planeve të bashkëpunimit me autoritetet civile sipas rajoneve të dislokimit, ku strukturat e BCU-së duhet të përgatisin dhe të përfshijnë në dosjen e planëzimit vjetor të tyre planet e bashkëpunimit me autoritetet civile, të përcaktuara sipas matricës kryesore të aktiviteteve të komandave dhe njësive. Në këtë seminar për të pranishmit u kërkua përgatitja e projekt-planeve ku të përfshiheshin veprimtari të ndryshme si, ditë të hapura për publikun, takime me autoritete të pushtetit vendor, me personalitete të fushave të ndryshme, me drejtues të shkollave etj, me qëllim për t'i njohur ata me aktivitetet që komandat/njësitë e tyre realizojnë në periudha të caktuara të vitit, për të siguruar kësisoj edhe një bashkëpunim të vijueshëm me ta.

Me qëllim përmirësimin e përmbajtjes dhe përgatitjes së informacionit për publikimin e tij në shtypin ushtarak apo në faqet e internetit të MM, SHP dhe Komandave të Forcave gjatë seminarit nga përfaqësues të shtypit ushtarak, gazeta "Ushtria" dhe revista "Mbrojtja", u trajtuan disa problematika të dala gjatë dokumentimit dhe publikimit të aktiviteteve kryesore të komandave dhe njësive. U theksua se në shtypin tonë ushtarak duhet të sjellim më shumë informacion nga jeta dhe veprimtaria, në radhë të parë, të ushtarakëve që punojnë e stërviten në repartet dhe nënrepartet, vështirësitë e punës së tyre, të ushtarakëve që shërbejnë në misione jashtë vendit, të atyre që përballen në emergjencat civile në ndihmë të komunitetit, të familjeve dhe fëmijëve të ushtarakëve; ka nevojë të publikojmë dhe përgjithësojmë më shumë stërvitjet ushtarake që bëhen brenda dhe jashtë vendit, mendimin ushtarak etj. Por që ta bëjmë më mirë këtë, u theksua se është e domosdoshme aktivizimi në shtyp i personelit të BCU-së. E kush më mirë se sa oficeri i J9-ës mund të shkruaj dhe të informojë nëpërmjet shtypit ushtarak për punën që bëhet nëpër reparte, e kush më mirë se sa ai njeh ata që dallohen në stërvitje, që sakrifikojnë më shumë, e kush më mirë se ata mund të përgjithësojë përvojat pozitive që nuk ka pak, individët që shquhen më tepër në procesin e zbatimit të detyrave ushtarake etj. Në shtypin ushtarak dhe në median sociale të MM lipset një bashkëpunim më i ngushtë me strukturat e BCU-së, nga niveli më i lartë dhe deri tek më i ulëti i tyre. Duhet një komunikim i vazhdueshëm me njëri-tjetrin, me telefona, në faqet e rrjetit social, të shkëmbejmë përvojat që kemi në interes të pasqyrimit sa më mirë të asaj që bëhet e realizohet çdo ditë nëpër repartet dhe nënreparte, atje ku punojnë dhe shërbejnë ushtarakët tanë. Këtu u soll përvoja pozitive, sidomos me strukturën e BCU-së në Forcën Tokësore, me Qendrën e Simulimit, të QPR-së etj. Çështjet që u trajtuan dhe problematikat që dolën në seminarin që Drejtoria e Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak në Shtabin e Përgjithshëm zhvilloi me strukturat e BCU-së të komandave Forcave dhe njësive të FA, u evidentuan dhe të gjitha këto do të shërbejnë për të realizuar me sukses misionin e BCU-së në të ardhmen. Duhet nënvizuar se, gjatë aktivitetit të përgjithshëm strukturat e BCU-së janë përpjekur të realizojnë në kohë dhe me cilësi të plotë të gjitha detyrat e ngarkuara, si dhe kanë dokumentuar, arkivuar dhe paraqitur më së miri aktivitetin e komandave dhe njësive ku ato shërbejnë, por ka dhe drejtime të cilat duhet trajtuar me vëmendje të veçantë dhe kanë nevojë për përmirësim. Pikërisht këto u bënë objekt diskutimi dhe zgjidhjeje edhe në këtë seminar me personelin e strukturës së bashkëpunimit civilo-ushtarak, të cilët, së bashku edhe me punonjësit e shtypit ushtarak dhe të medias sociale përbëjmë atë që mund të quhet Stafi i Imazhit i Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm dhe Forcave tona të Armatosura.

Asambleja Zgjedhore zgjodhi si President të SHKURSH-it, z. Thoma Konduri

Zhvilloi punimet Asambleja Zgjedhore e Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë

Asambleja analizoi me përgjegjësi punën 4-vjeçare të bërë nga ajo, Këshilli Drejtues dhe Bordi Ekzekutiv, si dhe përcaktoi objektivat dhe detyrat për të ardhmen

Për përmirësimin e gjendjes social-ekonomike të ushtarakëve, nga drejtuesit dhe forumet e shoqatës janë bërë shumë takime me Mnistrinë e Mbrojtjes dhe Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore.

Para disa ditësh, në sallën monitoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua mbledhja e Asamblesë Zgjedhore të Shoqatës së Ushtarakëve në Rezeve të Shqiperise (SHKURSH). Për nga tematika dhe çështjet që u trajtuan, kjo mbledhje përbënte një eveniment të rëndësishëm në jetën e ushtarakëve në rezervë, në lirim e në pension, anëtarë ose jo të kësaj shoqate.

Asambleja analizoi me pergjegjësi punën 4-vjeçare të bërë nga vetë ajo, Këshilli Drejtues dhe Bordi Ekzekutiv. Pasi u ekzekutua Himni Kombëtar dhe ai i CIOR-itm, u mbajt një minut heshtje në shënjë kujtimi dhe nderimi për shokët anëatarë të shoqatës, të cilët janë ndarë nga jeta gjatë këtij 4-vjeçari, ndërmjet të cilëve edhe Presidenti i SHKURSH-it, i paharruari kolonel (R) Mehdi Pogaçe.

Raportin mbi "Punën e bërë nga organet e zgjedhura të SHKURSH-it midis dy mbledhjeve dhe projekt vendimet" e mbajti Sekretari i Përgithshëm i SHKURSH-it, Zoi Kote. Raporti u përqëndrua në disa çështje kryesore, si: funksionimi i organeve të zgjedhura në qendër dhe në rrethe; mbi zbatimin e Ligjit Nr.10142, dt. 15.05.2009 , i ndryshuar, dhe vendimit Nr. 793, dt.24.09.2010, i ndryshuar, nga organet përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Sigurimeve Shoqerore; problemet ekonomike në shoqatë dhe gjendja financiare; puna me shtypin; realizimi i detyrave për zhvillimin e aktiviteteve me karakter kombëtar; marrëdhëniet e SHKURSH-it me CIOR-in.

Në raport u theksua se, për përmirësimin e gjendjes social-ekonomike të ushtarakëve, nga drejtuesit dhe forumet e shoqatës janë bërë shumë takime me Mnistrinë e Mbrojtjes dhe Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Nga ky angazhim i organeve të zgjedhura të SHKURSH-it janë realizuar përmirësime të ndjeshme në përfitimin e pensioneve të ushtarakëve, të pensioneve të pleqërisë dhe atë suplementar. Problem mbetet perfitimi i pensionit të parakohshëm të ushtarakëve në rezervë. Ky pension u reduktua dhe u perkeqësua nga nxjerrja e një Akti Normativ të qeverisë Berisha, i cili në dhjetor të vitit 2010 u kthye në ligj, duke i vënë kështu vulën e perkeqësimit të deritanishëm të trajtimit financiar të kësaj shtrese të shoqëisë shqiptare, madje duke prekur edhe Statusin e Ushtarakut, Ligjin Nr.9210, dt. 23.03.2004. Kohët e fundit Gjykatat Administrative, ushtarakëve në rezervë që kanë fituar pensionin e parakoheshëm në rrugë ligjore, po u përsërit gjykimin duke i nxjerrë debitor edhe ata që nga 1 korriku i vitit 2009. Kjo situatë e nderë është edhe për personat që janë në procesin gjyqesor. Prandaj dhe u theksua, se pavarësisht nga përpjekjet e bëra ato nuk duhen ndalur, ushtarakët dhe forumet drejtuese të shoqatës, në bashkëpunim edhe me shoqatat e tjera, të intensifikojnë më tej përpjekjet e tyre pranë institucioneve ligjëvënëse dhe ligjzbatuese.

Gjithashtu në raport u trajtuan edhe marrëdhëniet me CIOR-in, ku SHKURSH-i është prej viteh anëtare me të drejta të plota. Me gjithë vështirësitë financiare, shoqata ka marrë pjesë me delegacione të reduktuara në aktivitetet që janë zhvilluar më kuadër të CIOR-itj, duke siguruar shpenzimet nga vetë anëtarët e delegacionit. Në informacionin që dha z. Vlash Bushi, përgjegjësi për financat e SHKURSH-it, theksoi se burimet dhe të ardhurat e shoqatës janë paksuar, sepse anëtarët e saj nuk paguajnë rregullisht kuotat e anëtarësisë. U kërkua që të shtohet kujdesi dhe përgjegjësia për të vjelur në vazhdimësi dhe përdorur me me kujdes paratë që mblidhen nga kuotat e anëtarësisë. Por ndërkaq, u theksua që, pavarësisht nga vështirësitë financiare, duhen intensifikuar përpjekjet për të bërë të mundur sigurimin e një mbështetje financiare nga Ministria e Mbrojtjes, e cila ka për detyrë në bazë të Statusit të Ushtarakut që të mbulojë këto shpenzime.

Më pas, Sekretari Organizativ, z. Thoma Konduri mbajti raportin mbi disa ndryshime dhe shtesa në Statutin e SHKURSH-it. Ndryshimet konsistojnë në rivendosjen në strukturë të shoqatës të Këshillit Koordinues të SHKURSH-it për Qarkun. Kjo për arsye se do të lehtesojë mbajtjen e lidhjeve direkte Bord Ekzekutiv –Degë (sidomos me bashkitë e largëta) dhe, se dyti, struktura e shoqatës do t'i përshtatet më mirë ndarjes së re administrative e territoriale të vendit. Po kështu, Asambleja miratoi projekt-vendimet dhe materialet e tjera të saj. Nga të ftuarit, përsheëdeti Asamblenë e SHKURSH, nënkolonel Leonard Çoku, komandanti i Qëndrës së Personel-Rekrutimit, i cili pasi falënderoi shoqatën për ftesën u angazhua për një kontribut më të nirë në ndihmë të zgjidhjes së nevojave të ushtarakëve në rezervë, lirim e pension nga institucioni që ai drejton. Një pikë e rendësishme e kësaj mbledhjeje ishte edhe zgjedhjet e reja. Asambleja, pasi u konstitutua me 53 anëtarë të saj, rizgjodhi Këshillin Drejtues me 23 anëtarë, me përfaqësues një anëtar për çdo qark. Po kështu edhe 12 anëtarët e Bordit Ekzekutiv.

Gjithashtu, Asambleja zgjodhi si President të SHKURSH-it, z. Thoma Konduri, Sekretar të Përgjithshëm, z. Zoi Kote, zv/president, z. Skënder Kadiu dhe z. Enver Ajdari, Sekretar Organizativ, z. Hekuran Bajrami, si dhe sekretarët e tjerë sipas drejtimeve të përcaktuara.

Në fund, Presidenti i zgjedhur, z. Zoti Thoma Konduri, falënderoi anëatërt e Asamblesë për besimin që i dhanë me votën e tyre dhe premtoi se në të ardhmen, së bashku me të gjithë organet drejtuese të SHKURSH-it, do të luftojë për përmbushjen e detyrave që ka shoaqta dhe anëtarët e saj.

ZOI KOTE, ENVER AJDARI

Kush është kolonel (R) Thoma Konduri

Ka lindur në vitin 1945 në Kakodhiq, Delvinë. Në vitet 1959-1963 kreu studimet në shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej", 1963-1965 në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe në vitin 1970-1972 përfundoi studimet në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm të FA.. Si oficer i specilalitetit të Artilerisë Tokësore ka shërbyer në detyra të ndryshme, që nga komandant baterie në Peshkopi, shef artilerie në reparte e njësi deri në nivel Korpusi, komandant Brigade i Artilerisë në Bulqizë dhe në Tiranë dhe deri Ndihmës i zv.shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së për artilerinë (në rang drejtor i Drejtorisë së Artilerisë) në vitet 1999-2001. Ka një bekgraund të pasur në fushën teoriko-shkencore dhe në fushën aplikative, autor dhe pjesëmarrës me studime dhe kumtesa në shumë veprimtari shkencore, projektues i disa pajisjve dhe instrumenteve të artilerisë, etj. Pas daljen në rezervë në vitin 2011është angazhuar si një vëprimtarë i shquar i Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë, duke u zgjedhur në organet e saj drejtuese që nga viti 2007. Eshtë dekoruar me Medaljen e Shërbimit Ushtarak, Urdhërin "Ylli i Kuq" i klasit III dhe Urdhërin e Shërbimit Ushtarak të klasit I.

Gjeneralmajor Zyber Dushku vlerëson me certifikata tre nënoficerët më të mirë

Rreshter Dorjan Mema, fitues i vendit të parë, nëntetar Gentiana Xhametaj, fitues i vendit të dytë dhe nëntetar Arbër Dalliu, fitues i vendit të tretë

Pas përfundimit të konkurrimit final dhe përzgjedhjes së nënoficerëve më të mirë për vitin 2014, në ambientet e Komandës së Forcës Tokësore u zhvillua edhe ceremonia e dorëzimit të certifikatave të vlerësimit për tre nënoficerët më të mirë të vitit. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku dhe i gjithë personeli i shtabit të kësaj Komande. Gjeneralmajor Dushku, pasi vlerësoi punën e kujdesshme që u bë për përzgjedhjen përmes konkurrimit të nënoficerëve më të mirë për vitin 2014, i dorëzoi certifikatat e vlerësimit rreshter Dorjan Mema, fitues i vendit të parë, nëntetar Gentiana Xhametaj, fitues i vendit të dytë dhe nëntetar Arbër Dalliu, fitues i vendit të tretë.

Përzgjidhet nënoficeri më i mirë për vitin 2014

Rreshter Dorjan Mema, efektiv i Batalionit të Forcave Speciale shpallet nënoficeri më i mirë për vitin 2014 në Forcën Tokësore

NËNKOLONEL EDIAND ELEZI

Konkurrimi ishte vërtetë i fortë, ku spikati jo vetëm niveli i lartë i përgatitjes profesionale të pjesëmarrësve, por edhe edhe një shpirt gare i ndershëm dhe i paanshëm.

Para pak ditësh, në Komandën e Forcës Tokësore u zhvillua procesi i përzgjedhjes së nënoficerit më të mirë për vitin 2014. Për të arritur në përfundimin me sukses të këtij aktiviteti të rëndësishëm për trupën e nënoficerëve të Forcës Tokësore u planifikuan dhe u zbatuan një sërë masash, ndër të cilat mund të përmendim: hartimin dhe miratimin e dokumentacionit të nevojshëm (urdhëra, udhëzime, plane pune dhe takime informuese); mbledhja e bordit të vlerësimit për njohjen me praktikën e punës që do të ndiqej për aktivitetin; përzgjedhjen dhe grumbullimin e rezultateve të arritura përgjatë këtij viti nga trupa e nënoficerëve të Forcës etj.

Pas një përzgjedhje seleksionuese rigoroze, në konkurrimin final në nivel Force morën pjesë 17 nënoficerë të gradës nëntetar, tetar dhe rreshter, ku çdo repart i Forcës Tokësore përfaqësohej me nga 3 nënoficerë të përzgjedhur me shumë kujdes e paanësi më parë nga bordet e ngritura në këto reparte respektive. Risia e këtij viti ishte ngritja e Bordit të Vlerësimit në Forcën Tokësore me përbërje vetëm nga nënoficerë. Ky bord kryesohej nga rreshter Emiljan Dama me detyrë nënoficer i Forcës dhe përbëhej nga nënoficerët e batalioneve, si dhe specialistë të fushave të ndryshme në shtabin e Forcës Tokësore (personeli, operacionet/stërvitja dhe ndërlidhj). Konkurrentët u testuan duke u bazuar në pesë rubrika vlerësimi dhe më konkretisht:

A. Testi intelektual/profesional

B. Testimi i gjuhës së huaj (anglisht)

C. Testi i përgatitjes fizike

D.Performanca (vlerësimi vjetor i tre viteve të fundit)

E. Prezantimi i një teme ushtarake nga secili kandidat bazuar në standardet e mësimdhënies.Puna e bordit të vlerësimit u karakterizua nga profesionalizmi, paanshmëria dhe objektiviteti. Të gjithë anëtarët e bordit janë të mendimit se ky aktivitet rrit profesionalizmin, nxjerr në pah vështirësitë dhe motivon trupën e nënoficerëve për të kërkuar arritjen e standardeve të kërkuara me qëllim përfaqësimin sa më dinjitoz të kësaj trupe.

Mbas përfundimit të testimeve dhe bazuar në rezultatet e arritura nga secili kandidat u bë renditja e konkurrentëve sipas pikëve që grumbulluan. Konkurrimi ishte vërtetë i fortë, ku spikati jo vetëm niveli i lartë i përgatitjes profesionale të pjesëmarrësve, por edhe edhe një shpirt gare i ndershëm dhe i paanshëm. Nënoficeri më i mirë për vitin 2014 në Forcën Tokësore u shpall rreshter Dorjan Mema, efektiv i Batalionit të Forcave Speciale, në vendin e dytë u rendit nëntetare Gentjana Xhameta, efektiv i Batalionit të Dytë të Këmbësorisë dhe në vend të tretë nëntetar Arbër Dalliu, efektiv i Batalionit Komando.

Rreshter Dorjan Mema shërben prej 13 vitesh në Forcat e Armatosura të RSH. Karrierën e tij ushtarake e ka filluar në Brigadën Komando. Disa nga detyrat që kryer ndër vite janë: komandant skuadre, zv/komamndant toge, këshilltar i kompanisë dhe nga viti 2010 e këndej shërben në Batalionin e Forcave Speciale. Aktualisht kryen detyrën e specialistit për Xhenion në këtë batalion.

Në realizimin me sukses të aktivitetit shërbeu eksperienca dhe përvoja e fituar gjatë vitit të kaluar. Po kështu Forca Tokësore u përfaqësua edhe në nivel të Forcave të Armatosura me tre n/oficeret e mesiperm, të cilët respektivisht zunë vendin e dytë, të katërt dhe të dhjetin. Ne prerzantim e temave te lira nga ana e nënoficerëve të Forcës Tokësore ra në sy përgatitja e lartë e tyre, e cila u vlerësua dhe nga bordi i vlerësimit në FA. Nga ana e përfaqësuesve të FT u vu re edhe një përgatitje shumë e mire në zoterimin e gjuhës së huaj (anglisht), gjë që lidhet me detyrat e kryera nga ata si brenda dhe jashtë vendit, në misione paqeruajtëse dhe stërvitje shumekombëshe. Ky përfaqësim dinjitoz dhe rezultati i arritur prej tyre tregon qartë nivelin e lartë të përgatitjes së trupës së nënoficerëve të Forcës Tokësore, të cilët padyshim kanë vendin dhe rolin e tyre shumë të rëndësishëm në tërë piramidën e kësaj Force.

Flet ish-ushtaraku dhe basketbollisti i mirënjohur i "Partizanit" dhe i Kombëtares, Robert Kuqo

Robert Kuqo, një nga emrat legjendë të basketbollit shqiptar

"Kam luajtur 74 ndeshje ndërkombëtare, ku kemi fituar me të gjitha ekipet e vendeve lindore, ndërsa me "Partizanin" kam 15 tituj kampion"

ALBERT Z. ZHOLI

Robert Kuqo mbetet një ndër basketbollistët shqiptar më të dëgjuar të të gjithë kohërave. E filloi basketbollin në qytetin e lindjes, në Pogradec, dhe më pas e vazhdoi tek ekipi i mirënjohur i "Partizani" me të cilin fitoi 15 herë titullin kampion. Ai ka një rekord absolut, pasi në tërë karrierën e tij si basketbollist nuk ka marrë asnjë karton të verdhë. Ka qenë shef fizkulture i Divizionit të Pestë për më shumë se 18 vjet. Ruan mjaft nostalgji për jetën ushtarake, sepse, siç thotë ai, kishim një shoqëri të mirë, marrëdhënie të mrekullueshme, respekt reciprok dhe një ndihmesë të jashtëzakonshme për njeri-tjetrin, pasi vetëm kështu kaloheshin vështirësitë ekonomike dhe problemet stresante të atij sistemi. Sipas tij, sporti në atë kohë kishte përparësi, ku mbi të gjitha ekzistonte loja kolektive, dashuria dhe ndihma e pafund për njëri-tjetrin, cilësi të cilat për fat të keq, shprehet ai, janë zbehur. Ai veçon dy momente në sport, kur luajti në Bratislave ditën që i kishte ndërruar jetë babai dhe në një ndeshje me Italinë kur luajti me dorë të thyer.

Robert Kuqo ka një rekord absolut, pasi në tërë karrierën e tij si basketbollist nuk ka marrë asnjë karton të verdhë. Ka qenë shef fizkulture i Divizionit të Pestë për më shumë se 18 vjet. Ruan mjaft nostalgji për jetën ushtarake

Ushtarakët dhe në tërësi lexuesi i sotëm dëshiron të dijë diçka më shumë për jetën tuaj, jo vetëm si sportist, por edhe si ushtarak?

Unë vij nga qyteti i Pogradecit. Kam filluar punë që në moshën 10-vjeçare, pasi kishim një gjendje ekonomike shumë të varfër. Në kohën e pushimeve të shkollës punoja në fermë, pastaj fillova punë si mekanik në fabrikën e verës. Aty më erdhi një mësues pikture, Vangjo Vasili, që kishte qenë basketbollist me studentin dhe më thotë pse nuk fillon dhe ti sportin. Unë që në atë moshë isha 182 cm i gjatë. Kështu vendosa të shkoj në basketbollin e qytetit tim të lindjes ku kam luajtur rreth 3 vjet. Po nuk ishte ai basketboll modern që luhej në Tiranë, apo në Korçë, Shkodër apo në Durrës. Unë i respektoj këta ekipe, pasi kishin në përbërje basketbollist që i dhanë emër jo vetëm këtyre qyteteve, por tërë Shqipërisë. Në këtë kohë ftohem të luaj me të rinjtë e "Partizanit". Njazi Lleshi, trajneri i njohur i të rinjve të "Partizanit", nuk kishte marrë asnjë titull kampion pasi nuk kishte një qendër të mirëfilltë. Pikërisht, profesor Njaziu kishte dëgjuar për mua dhe më propozoi të shkoja në Tiranë, me ndihëm e gjeneral Petrit Dumes, i cili ishte shefi i Shtabit të Përgjithshëm i ushtrisë shqiptare dhe kishte shumë dobësi për sportin, madje për basketbollin në mënyrë të veçantë. Më 5 maj 1971 unë erdha tek "Partizani", në moshën 17 vjeçare, pasi kisha disa vite që luaja me ekipin e Pogradecit. Nga të gjithë specialistët e basketbollit, nga të gjithë trajnerët e ekipeve të tjerë, mendimi ishte se Robert Kuqo nuk do të bëhet kurrë lojtar i mirë. Ishte vetëm nxitja dhe dëshira e madhe e trajnerit Njazi Lleshi që unë të futesha në të fshehtat e basketbollit. Aty në stërvitje pashë se si luhej basketbolli modern, se si bëhej një stërvitje moderne. Falë ndihmës së madhe të qendrës së Partizanit, Nikolin Pali (veteriner, sot në SHBA), unë arrita të mësoj se si punohet, se çfarë rregullash duhej të zbatoja që të bëhesha basketbollist profesionistë. Njëkohësisht, falë ndihmës së kapitenit Besnik Pëllumbi (Keçi), një njeri që na mbante shumë afër ne të ardhurve (edhe Kastriot Mushi), unë mundohesha të ingranohesha në basketbollin modern. Ishte një kohë kur shoqëria ishte e jashtëzakonshme, ashtu si nuk është sot. Unë po them se, punoja 3 herë në ditë nga 2 orë, pra 6 orë në ditë stërvitje. Një stërvitje që nuk mund ta përcaktoj dot. Në këtë kohë më thërrasin ushtar dhe shkoj dy muaj në karantinë. Pas dy muajsh më heqin si ushtar dhe më thërrasin në ekip. Ishte një moment i veçantë. Tashmë më kërkonin tek të rriturit. Duhej të luaja me të madhin Agim Fagun, duhej të luaja me Besnik Pëllumbin, duhej të luaje me të paharruarin Kushtrim Zaçen dhe figura të tjera të mëdha të basketbollit shqiptar. U detyrova të punoj më shumë dhe arrita që në vitin 1972, pra për një vit, të luaj me ekipin e parë. Ishte e pabesueshme, pasi dihet nga vija dhe ku po përballesha.

Kur ke luajtur për herë të parë me ekipin e parë të "Partizanit"?

Me ekipin e parë kam luajtur, përkrah Agim Fagut, në një ndeshje të vështirë, pasi u largua Kushtrim Zaçe sepse martonte motrën në Tepelenë dhe Kastriot Mushi kishte shkuar në Elbasan (1972). Në këtë ndeshje kam luajtur i vetëm në qendër kundër "Dinamos" dhe mbuloja Mim Rusin, i cili ishte një ndër qendrat më të mira të Shqipërisë në atë kohë. Në atë ndeshje dhashë të gjitha energjitë e mia dhe e mposhta Rusin, i cili ishte i një niveli shumë të lartë. Kështu duke u udhëhequr nga Agim Fagu ne bëmë një fitore shumë të vështirë, pasi na mungonin dy figurat qendrore të ekipit. Më 1972 kam luajtur si rezervë i dytë apo i tretë, sepse trajneri i ekipit të parë të "Partizanit", Astrit Greva, nuk kishte ende besim tek unë. Kjo edhe pasi kishte lojtarë më cilësorë në atë kohë. Më vonë, me punën time e binda Astrit Grevën dhe ai më mbajti në skuadrën e parë edhe mbasi mbarova ushtrinë, sepse mund të kthehesha në Pogradec. Më tha se do të mbajmë si titullar, si lojtar i parë i ekipit të Partizanit.

Pra, mes yjeve të basketbollit, kur e pe veten se ishe një ndër ta?

Në vitin 1974, në një ndeshje ndërkombëtare me Luksemburgun, unë kam luajtur vetëm 5 minuta në Tiranë dhe në Luksemburg gjysmën e lojës. Kur u kthyem prej andej u largua nga ekipi për arsye biografie (!) qendra e ekipit kombëtar, Nikolin Pali. Pas largimit të tij unë u futa në rolin e tij me fanellën me numër 12 që ma fali ai. "Ta gëzosh, - më tha ai, - pasi ti punon shumë, më shumë nga ne dhe me punë arrihet çdo gjë". Kam luajtur në këtë kohë kundër "17 Nëntorit" të Tiranës dhe kam shënuar 24 pikë. Ishte viti 1974. Ishte një ditë kur nuk do të luante Nikolin Pali dhe stoli i "17 Nëntorit" tha se "Partizani" do ta humbas ndeshjen. Në atë kohë konkurrenca më e madhe ishte "Partizani" - "17 Nëntori". Pallati i sportit atë ditë (por jo vetëm atë ditë, por gjithmonë) ishte i tejmbushur. Nuk pritej që Nikolini të mos luante, as e besonte kush. Por në atë kohë, apo një ditë më parë, Petrit Dume u shkarkua nga zv.ministër i Mbrojtjes dhe Shef i Shtabit të Përgjithshëm dhe dihej që Nikolini ishte me biografi të keqe dhe e mbante vetëm gjeneral Petriti. Këto janë çudira shqiptare të biografisë, por kështu ishte ajo kohë. Kjo ndeshje ishte deçizive. Kush fitonte dilte kampion. Në Pallatin e Sportit një atmosferë e zjarrtë. Të gjithë kur nuk panë Nikolinin në fushë thanë "Partizani" do të humbasë. Por fati ishte me mua. Më doli loja dhe me ndihmën e shokëve shënova 24 pikë dhe e mundëm "17 Nëntorin" me 10 pikë diferencë. Pas këtij takimi për shumë vjet rresht "17 Nëntori" nuk ka fituar asnjë ndeshje me ne. Kam 15 tituj kampion tek "Partizani". Deri në vitin 1985 unë kam qenë kampion me "Partizanin".

Si ishte "Partizani" i asaj kohe?

Një ekip shembull, me një frymë miqësore të jashtëzakonshme, me kulturë, me një edukatë shumë të lartë, me

FIGURA TE SHQUARA

Plejada e artistëve, shkrimtarëve, historianëve apo sportistëve të asaj kohe i bën nder këtij vendi edhe sot dhe kjo s'ka përse të mohohet. Figura të shquara si Dritëro Agolli, Isamail Kadare, Fatos Arapi, Eqrem Çabej, Aleks Buda, Kristo Frashëri, Farudin Arapi, Panajot Kanaçi, Besim Zekthi, Gaqo Çako, Avni Mula, Loro Boriçi, Panajot Pano, Fatmir Frashëri, Safet Berisha, Agim Fagu, Asllan Rusi, Shaban Uka, Ymer Pampuri e shumë të tjerë do të duhen vite dhe dekada që t'i vijnë këtij kombi...

frymë bashkëpunuese që se gjen kurrë sot. Me këtë frymë, në sajë të ndihmës së basketbollistëve të shkëlqyer, edhe unë arrita të bëhem një ndër basketbollistët më në zë të kësaj periudhe. Që në 1974, unë fillova të angazhohem edhe me ekipin Kombëtar, njëkohësisht në këtë vit, lojtarët e përparësisë patën një përfitim tjetër, 200 lekë ushqim për trajtim të veçantë. Kjo përveç rrogës. Ishte Agim Fagu, Kushtrim Zaçe, Kastriot Mushi dhe unë që e përfituam këtë ushqim special. Këtë ushqim ne e hanim në klub. Ishte koha kur ekipi ynë, po merrte lojtarë të rinj, dhe po rifreskohej. Në vitin 1977 erdhi pranë nesh Gazmend Çaçi.

Sa ndeshje ndërkombëtare keni luajtur?

Kam luajtur 74 ndeshje ndërkombëtare. Unë kam dalë shënuesi më i mirë i shumë ndeshjeve ndërkombëtare si në Tiranë edhe jashtë vëndit. Këtu mund të përmend skuadrën "Honleti" të Budapestit, ku si atje dhe këtu isha shënuesi më i mirë. Një ndeshje tjetër interesante ishte kundër "Inter" të Bratislavës, ku për 27 minuta kam bërë 24 pikë dhe deri në fund të lojës kam shënuar 32 pikë, ndonëse nuk luajta gjithë ndeshjen. Me këtë fitore ne zumë vend të dytë në grup. Ne luanim në grup, e pikasnim lojën dhe nxirrnim atë që duhej të gjuante në kosh. P.sh., kur u nisëm për në Bratislavë, mua më kishte vdekur babai dhe nuk më kishin thënë, pasi duhej patjetër që të fitonim. Në atë ndeshje më mbanin ndër kryesorët. Unë në atë ndeshje kam shënuar 18 pikë dhe duhej të luaja me Gaz Çaçin që kishte supermaci në gjatësi dhe në këtë ndeshje bëri 30 pikë. Ishte një fitore dinjitoze. Këtu dua të përmend edhe fitoren me CSKA e Sofjes, që e kemi eliminuar apo disa ekipe turke. Pra, kemi arritur rezultate me ekipe me emër në Evropë. Gjithë Lindja është eliminuar në Shqipëri, të gjithë. Madje shumicën e ekipeve greke i kemi mundur, madje me rezultate domethënës. Ishin ekipe që përbënin themelin e kombëtares greke dhe që më vonë dolën Kampion Europe, por ne i kemi mundur. Ne kishim vetëm një mungesë, nuk kishim një qendër (lojtar) mbi 2 metër e 4 cm. Na mungonte kjo gjatësi në ekip. N.q.s. do kishim dhe këtë, do ishim ndër të parët në Europë. Ne kishim sulme të shpejta, kishim kombinime të mrekullueshme, luanim në grup dhe kurrë nuk fyenim shokun që nuk bëri kosh, por vraponim sërishmi për të kapur topin, për të kthyer reston, për të bërë kosh. Ky ishte motivi ynë. Ekipin e "17 Nëntorit" që e kishim konkurrentin numër një e mposhtnim fizikisht, pasi taktikisht ndoshta nuk ishim aq lart, por bënim presing dhe fitonim. Një gjë nuk mund të mos e veçoj, madje edhe në cilësinë e kapitenit të ekipit të Partizanit dhe ekipit Kombëtar, që mbas vitit 1990 asnjë prej këtyre basketbollistëve të shkëlqyer nuk ka marr asnjë vlerësim, asnjë titull, asnjë dekoratë. Çudi!

Po ndonjë ndeshje tjetër ndërkombëtare me famë apo që iu ka mbetur në kujtesë?

Po, kundër ekipit italian të "Skuip Kantus", që drejtohej nga një prej trajnerëve më të mirë në botë, ne bëmë një ndeshje të madhe. Unë në atë ndeshje u futa me vonesë. Trajneri i ekipit italian i thotë Astrit Grevës në fund të ndeshjes: Pse e futët me vonesë nr 12? Unë atëhere kisha thyer dorën e djathtë dhe jam futur në ndeshje me dorë të thyer dhe kam shënuar 24 pikë. E pabesueshme mund t'ju duket, por është e vërtetë. Kjo dorë më dhemb edhe sot (e kishte të lidhur me fashë kur bisedonim). Isha shënuesi më i mirë i asaj ndeshje dhe pse me dorë të thyer. Basketbollisti Pirro Koleka që trajneri e kishte marrë në përforcim, i thotë shokëve: po Greva si i thotë bëhu gati Kuqos, kur unë jam gati për ndeshje?! Të them të vërtetën, Pirro ishte lojtar shumë i mirë. Por, vendoste trajneri…Kjo ndeshje është luajtur në Durrës në vitin 1983. Ne nuk fituam, por luajtëm aq fort sa fitorja e miqve italian me famë në botë erdhi me shumë vështirësi dhe e kishte bërë trajnerin e tyre me djersë. Humbja do ishte e kushtueshme për ta. Dua të them se kundër Italisë dhe ish-Jugosllavisë ne nuk kemi fituar asnjë ndeshje, pasi ata kanë pasur basketboll të klasit botëror. Ata kanë pasur më shumë përvojë, më shumë aktivitetet ndërkombëtar, por mbi të gjitha kishin basketbollist të gjatë. Gjithsesi, rezultatet që kemi arritur ne nuk do arrihen kurë.

Po sot?

Ke dëgjuar për basketboll sot? Ku ka sot basketboll? Djali im është sportist dhe ka mbi 10 vjet në Euroligë, ka luajtur në ekipet më të mira të Europës dhe me ekipin Kombëtar të Turqisë, ku ka dalë në 6 lojtarët më të mirë të botës. Erdhi këtu për të dhënë ndihmë, por askush nuk e afroi, askush nuk i hapi derën. Sot, po të ngresh probleme në institucione që investojnë për basketbollin, të kthejnë kurrizin. Sot në Shqipëri, po s'u ngrit sporti, po s'u ngrit arti, po s'u fut turizmi masiv, ne sado të thotë ish- kryeministri që kemi ngritje ekonomike pas Gjermanisë, do ngelemi të varfër. Kultura, sporti, arti, është demokracia më e bukur.

Përpos këtyre arritjeve, si ju lidhi jeta me ushtrinë?

Unë nuk kam pasur në vitet e rinisë një shkollë të mirëfilltë ushtarake. Kur isha fëmijë, gjyshi im më vuri në një tavolinë një laps, një fletore, një libër, një makinë, një lodër elefant dhe të tjera. Midis atyre dhe një pistoletë. Unë zgjodha pistoletën. Pra që fëmijë kur isha pak më shumë se një vjeç zgjodha armën, pasi kisha shumë qejf rregullin, disiplinën. Që në shkollë apo ushtar kur shkonim për qitje merrja vetëm notën 10, si në pistoletë dhe në pushkë. Për këtë arsye, pasi mbarova shkollën e fizkulturës u vesha nënoficer, pastaj pasi mbarova studimet në Institutin e Lartë të Fizkulturës u titullova oficer. Si sportist nuk kam marr kurrë asnjë kartelë të verdhë, po ashtu dhe si oficer nuk kam marr kurrë asnjë vërejtje apo ndëshkim disiplinor nga eprorët e mi. Isha dhe jam për rregull, disiplinë, korrektësi, saktësi dhe përparim. Por (qesh), nuk mund të gënjej: vetëm njëherë kam marrë në jetë vërejtje, kur ika njëherë nga puna para kohe për t'i marrë qumësht dhe gjalpë fëmijëve. Për shume vite kam qenë shefi i Fizkulturës i Divizionit të Pestë këtu në Tiranë.

A kishte disiplinë të fortë ushtria në atë kohë dhe si ndiqej hierarkia?

Disiplina ishte absolute. Disiplinë që ke qejf ta mendosh sot. Por kishte dhe mirëkuptim, kishte dhe mirëbesim mes shoku-shokut. Nuk ka përse të mohohet, në atë kohë edhe hallet e ushtarakut zgjidheshin si për strehim, punësim apo edhe arsimim të familjarëve të tyre. Për padrejtësitë që mund të bëheshin kishe ku dhe si të trokisje. Institucionet i kishe në hallkë zinxhiri. Por edhe miqësia e asaj kohe më duket se ishte më e sinqertë, më njerëzore, po kështu korrektesa, ndershmëria, sakrifica…Të gjitha këto nuk ka përse të mohohen, ndofta këto na i lehtësonin edhe hallet, që padyshim nuk ishin të pakta…

Kë mund të kujtosh nga ushtarakët e asaj kohe që ke punuar apo shërbyer?

Së pari, Novruz Sako. Një oficer me kapacitet profesional, një komisar korrekt, i gjendur, i saktë. Për çdo hall të ndihmonte. Unë kisha në atë kohë problem strehimin, pasi isha vetë i katërt, dhomë e kuzhinë. Në një mbledhje u ngrita dhe thashë se pse në pallatet që ndërtojmë bëhen hyrjet dhomë e kuzhinë, kur duhet të bëhen dy dhoma e kuzhinë? Atë kohë do isha kryqëzuar nëse nuk do ishte një komisar i mirë si Novruz Sako. Kam respekt për Beqir Ballukun, ish-ministrin e Mbrojtjes, njeri i dashur, miqësor me të gjithë. Kam pasur një hallë (motrën e babait), burri i së cilës ishte futur në burg. Unë nuk shkoja jashtë shtetit për ndeshje për biografinë e hallës. I qava hallin Beqir Ballukut dhe i thashë: ç'faj kam unë se që ka burrë halla? Ai qeshi dhe pas këti takimi mua nuk më penguan më për të dalë në takimet sportive jashtë shtetit. Maliq Sadushi, Llambi Gegprifti ishin zv.ministra të Mbrojtjes, por njerëz të komunikueshëm, që të qanin hallin kur i trokisje në derë…Më pas, në fillimet e demokracisë mua më quajtën të kuq, nuk e di pse (qesh). Nuk isha as komunist, as isha marrë ndonjëherë me politikë. Më thirri dikush, një mik që merrej me sportin dhe më thotë: Hajde të të japim teserën e të persekutuari politik, por unë nuk e pranova. S'kisha pse ta bëja këtë. Për fat të keq jo pak prej tyre që sot vetëquhen të persekutuar nuk janë të tillë. Janë vetëquajtur të tillë pasi marrin shpërblime. Ka prej tyre edhe nga rradhët e sportistëve. Më vjen shumë keq që sot nuk mer shpërblim Ymer Pampuri, shtangisti legjendë dhe marrin disa njerëz anonimë, që sportin e kanë parë me dylbi…

Ju thatë që Petrit Dume ishte jashtëzakonisht i lidhur me klubin "Partizani". Mbani mend ndonjë sjellje apo veprim që ju ka ngelur në kujtesë?

Ah, po. Ishte viti 1974. Si ekipi i futbollit dhe ai i basketbollit do të ndesheshin me skuadrën e Korçës, në të dy sportet. Ne si basketbollist fituam, futbollistët humbën. Petrit Dumja u nxeh shumë. Ai për sportin bënte namin. Mblodhi futbollistët pas ndeshjes dhe u thotë nisuni për Tiranë me këmbë. Dhe ata u nisën. Vetëm ku kishin bërë 10 km rrugë drejt Pogradecit erdhi autobusi dhe i mori. Gjeneral Petrit Dumja ishte shumë autoritar, por ne sportistët e donim dhe e vlerësonim shumë…

Po me drejtues të tjerë të lartë të ushtrisë të asaj kohe jeni takuar?

Të më kuptoni drejtë. Ne sportistët në atë kohë ishim disi të privilegjuar dhe shumica e drejtuesve jo vetëm të ushtrisë, por edhe të shtetit na kanë njohur dhe na kanë vlerësuar. Ju thashë, Maliq Sadushi, Llambi Gegprifti ishin zv.ministra të Mbrojtjes dhe ishin shumë të komunikueshëm me ne. Nuk di, por është fakt që në atë kohë arti, kultura, sporti respektohej dhe u jepej përparësi. Këtu nuk është se po them diçka që nuk shkon, që nuk është e vërtetë. Plejada e artistëve, shkrimtarëve, historianëve apo sportistëve të asaj kohe i bën nder këtij vendi edhe sot dhe kjo s'ka përse të mohohet. Figura të shquara si Dritëro Agolli, Isamail Kadare, Fatos Arapi, Eqrem Çabej, Aleks Buda, Kristo Frashëri, Farudin Arapi, Panajot Kanaçi, Besim Zekthi, Gaqo Çako, Avni Mula, Loro Boriçi, Panajot Pano, Fatmir Frashëri, Safet Berisha, Agim Fagu, Asllan Rusi, Shaban Uka, Ymer Pampuri e shumë të tjerë do të duhen vite dhe dekada që t'i vijnë këtij kombi…

Rruga historike e Flotës Ushtarake Detare, një rrugë e mundimshme, por e lavdishme

Në kuadër të 89-vjetorit të krijimit të Flotës Ushtarake Detare Shqiptare

Kapiten i Rangut të Parë (R)
ARTUR MEÇOLLARI,
N/kolonel (R) DR. ASLLAN ZEMANI*

Modeli i motovedetave "Shqipnia" dhe "Skënderbeg" të realizuar nga isht oficeri i marinës Luan Shabani (Shipmodelling "NAVAL") dhe minaheqësja gjermane të Klasit FM 1

Anija e parë ushtarake që ka mbajtur flamurin e shtetit shqiptar është jahti ushtarak austro-humngarez "Taurus". Jahti ushtarak austro-humngarez "Taurus" mbante flamurin austro-humgarezë dhe qysh nga viti 1912 qëndronte në bazën detare austro-hungareze në Stamboll.

Fillimet e marinës ushtarake

Shqipëria është një vend bregdetar me tradita të herëshme detarie. Historia e detarisë shqiptare është po aq e lashtë sa edhe vetë kombi shqiptar. Mbas shpalljes së Pavarësisë dhe krijimit të qeverisë së parë me në krye patrotin dhe plakun e urtë Ismail Qemali, më 28 nëntor 1912, Shqipëria krijoj ushtrinë e saj kombëtare me ministër Mbrojtje (Luftës) Mehmet Pashë Drallën. Kjo forcë ushtarake konsistonte vetëm në forca këmbësorie dhe nuk kishte në përbërjen e saj asnjë anije me karakteristika ushtarake. Gjatë qeverisjes së Ismail Qemalit në pak më shumë se një vit, por edhe në vitet që pasuan shteti i ri shqiptar nuk arriti të ngrinte marinën e tij ushtarake. Me ardhjen e Princ Vidit si Mbret i Shqipërisë, nis edhe periudha e pajisjes me anije të karakterit ushtarak. Fillimet e shërbimit të marines luftarake në Shqipëri nisin në vitin 1914, por si një shërbim i organizuar ai daton më 25 dhjetor 1925 dhe sidomos në vitin 1928 kur u krijua Komanda e Marinës në Durrës.

Anija e parë ushtarake që ka mbajtur flamurin e shtetit shqiptar është jahti ushtarak austro-humngarez "Taurus". Jahti ushtarak austro-humngarez "Taurus" mbante flamurin austro-humgarezë dhe qysh nga viti 1912 qëndronte në bazën detare austro-hungareze në Stamboll. Në 5 mars 1914 jahti ushtarak "Taurus" ngriti për here të parë flamurin shqiptar në Trieste. Këtu, në 5 mars 1914 jahti "Taurus" mori në bord Princin Ëillian de Ëied (Princ Vidin), Mbretin e Shqipërisë. Jahti nisi lundrimin në datën 6 mars i shoqëruar me nderime nga kryqëzori franceze "Bruix", kryqëzori i lehtë britanik "Gloucester" dhe kryqëzori i lehtë italian "Quarto". Flotilja e vogël arriti në Durrës më 7 mars 1914, ku Princ Vidi morri titullin "Mbreti Ëilliam i Shqipërisë".

Jahti "Taurus" është anija e parë ushtarake që ngre flamurin e Shqipërisë. Ajo ishte një anije me një ekujpazh prej 48 marinarë dhe vetëm flamurin kishte shqiptar, pasi emri dhe ekujpazhi ishin të huaj. Nga nëntori 1918 deri 1920 "Taurus" shërbeu si anije patrulluese italiane "Marechiaro". Në vitin 1928 u kthye në Shqipëri dhe iu vendos emri "Aurora" duke shërbyer si jaht i kryeministrit. Në 1938 u armatos përsëri duke u kthyer në anije patrulluese, por në shtator 1943 u mbyt në det larg Ankonës, në ujrat italiane.

Anija e dytë ushtarake e Shqipërisë është avullorja tregëtare austro-hungrareze "Herzegovina". Kjo anije u mor fillimisht me qera nga një kompani transporti detar dhe u përdor për transport mallrash. Në maj të vitit 1914 avullorja u pajis me një top malor, i cili u montua në bashin e saj

Vendosja e topit dhe shtimi i ekuipazhit u bë me qëllim që të përdorej gjatë kryengritjes kundër Princ Vidit. Ajo u përdor për të bombarduar qytetin e Kavajës shumë herë, por pa ndonjë efekt derisa ra në cekinë dhe u dëmtua shumë edhe nga rebelët. Pasi u nxorr nga cekina "Herzegovina" iu kthye pronarit dhe nuk u përdor më për qëllime ushtarake. Megjithatë avullorja "Herzegovina" mund të konsiderohet anija e parë ushtarake, e cila është përdorur për në veprime luftarake. Kjo anije ka operuar në Shqipëri nga maji deri në shtator 1914. Është ndërtuar në vitin 1913 në Akers MEKANISKE VERKSTED A / S - Christiania, Oslo. Përmasat 56.1 m x 9,2 m x 4,3 m, tonazhi 664 ton, shpejtesia 10 nyje dhe është shkrirë në vitin 1960.



Avullorja "Herzegovina". Foto e realizuar në Trieste, pjesë e koleksionit të shoqerisë "Naklada Benja"

Krijimi i Marinës Ushtarake Shqiptare

Marina Luftarake e Shqipërisë është krijuar më 25 dhjetor 1925, ditën në të cilën anijet "Shqipnia" dhe "Skënderbeg" mbërritën nga Italia. "Shqipnia" dhe "Skënderbeg" janë anijet e para luftarake në pronësi të shtetit shqiptar. Më parë atyre iu ishte bërë një mirëmbajtje e plotë në Itali. Një vit më pas, në vitin 1926 nga Italia erdhën edhe katër motovedetat 44 tonëshe ("Tirana", "Saranda", "Durrësi" dhe "Vlora"), të cilat kishin shërbyer gjatë Luftës së Parë Botërore. Në vitin 1926 presidenti i Shqipërisë, Ahmet Zogu, i dorëzoi sigurinë e Shqipërisë Italisë nëpërmjet Marrëveshjes së Dytë të firmosur më 27 nëntor 1926. Pakti i lejonte Marinës Mbretërore Italiane të drejtën e përdorimit të Portit të Vlorës, si dhe marrjen e armatimeve nga Italia. Në 24 qershor 1928 u krijua Komanda e Marinës Mbretërore me vendkomandë në Durrës. Në vitin 1938 mbërriti në Shqipëri edhe jahti mbretëror "Iliria".

Midis viteve 1925 deri ne vitin 1939 komandantët e Marinës Mbretërore të Shqipërisë kanë qënë oficerët e Marinës Mbretërore të Italisë, Kapiteni i Rangut të Tretë Giuseppe Prelli (1925-1931) dhe Kapiteni i Rangut të Trete Silvio Montanarella (1931-1939).

Është edhe një fakt interesant që zbulohet në 19 nëntor 1929 nga gazeta hollandeze "Het Vaderland", e cila shkruante se, Mbretëria Shqiptare kishte porositur tek Ansaldo Yard i Genovës (Itali) ndërtimin e një kryqëzori të lehtë

Ne foto: **Kapiten i Rangut te Pare Giuseppe Prelli, në bordin e anijes italiane ndihmuese të Flotës ERITREA në Shangai me 4 maj 1942. Foto është marrë nga Zyra Historike e Mainës Luftarake Italiane**

Modeli i motovedetave "Tirana", "Saranda", "Durrësi" dhe "Vlora" të realizuar nga ish-oficeri i marinës Luan Shabani (Shipmodelling "NAVAL") dhe motovedetës amerikane të Klasit ELCO

6000 tonësh, për stervitje, tregimin e flamurit dhe detyra mbrojtëse. Në këtë kohë personeli i Marinës Mbretërore ishte 100 vetë, por ishte parashikuar të rritej numri, përderisa ekuipazhi i kryqëzorit ishte 300 vetë. Kryqëzori ishte parashikuar të bazohej në Vlorë. Lajmi për porositjen e një kryqëzori në Itali nga Mbretëria Shqiptare në atë periudhë e kanë raportuar edhe gazeta britanike "The Observer", si dhe gazeta "Vullneti" Nr. 14 e datës 1 janar 1930. Në periudhën midis dy luftrave Ansaldo Yard i Genovës ka qënë një nga kantieret më aktive në Itali. Ai është themeluar në vitin 1853 dhe ka pushuar aktivitetin në vitin 1993 duke u thithur nga Fincantieri. I vetmi klas kryqëzori i prodhuar nga Ansaldo, i cili përputhet me të dhënat e "Het Vaderland", është Kryqëzori i Lehtë i Klasit "Alberto da Giussano". Gjithsesi një kryqëzor i tillë për Marinën Mbretërore të Shqipërisë nuk erdhi asnjë herë.

Organizimi i Marinës Mbretërore.

Në vitin 1933 u bë riorganizimi i Ushtrisë Shqiptare, ku u përfshi edhe Marina Mbretërore. Komandanti i Marinës Mbretërore ishte një oficer detar me gradën Kapiten i Rangut të Dytë ose Tretë. Komandanti ishte italian, kurse zv.komandant ishte Sulejman Kapedani. Marina Mbretërore përbëhej nga Marina Luftarake dhe Marina Tregtare.

Struktura e Marinë Mbretërore përbëhej nga: shërbimi i ndërlidhjes, armatimi dhe mbrojtja bregdetare, lundrimi, informacioni, stërvitja dhe edukimi, shëndetësor, bazat detare të Vlorës dhe Sarandës etj.

• Zyra e Parë: Shtabi i Marinës në vartësi direkte të Komandantit. Nga ky shtab vareshin Zyra e Dytë dhe e Tretë që përfaqësonin Marinën Luftarake dhe Zyra e Katërt që përfaqësonte Marinën Tregtare.

• Zyra e Dytë: Shërbimi ushtarak, teknik dhe administrativ. Nga kjo zyrë varej Baza Detare e Durrësit, kazerma ushtarake, shërbimi i mirëmbajtjes dhe shkolla e detarëve etj.

• Zyra e Tretë: Armatimi ushtarak detar. Nga kjo zyrë vareshin shërbimi i studimeve dhe projektet e zbatimit.

• Zyra e Katërt: Shërbimi detar dhe portual. Nga kjo zyrë vareshin portet, kapiteneritë e porteve, shërbimi i peshkimit, kontrolli i trafikut detar etj.

Anijet e Marinës Luftarake ishin të shpërndara në katër stacione detare të Shëngjinit, Durrësit, Vlorës dhe Sarandës.

"Shqipnia" dhe "Skenderbeg"

Ish minaheqëse gjermane të Klasit FM 1.

Anije minaheqëse bregdetare e ndërtuar për Forcat Detare Gjermane e Klasit FM 1 e projektuar në vitin 1917 me numër bordi M 16 ("SHQIPNIA") dhe M23 ("SKËNDERBEG"). U prodhua nga Dresdener Maschinen-Fabrik & Schiffsëerft "Übigau". Hyri në shërbim në 31 dhjetor 1919. Fillimisht u shit nëpërmjet një banke rumune në Bukuresht. Erdhi në Shqipëri më 25 dhjetor 1925. Doli nga armatimi dhe u shkatërrua përpara prillit të vitit 1939.

Tonazhi: 193 ton (I plotë), 170 ton (standard)
Përmasat:: gjatësia 43.00 m , gjerësia 6.00 m; peshkimi 2.29m
Motorat:: dy motora vertical me tre cilindra. Tre motora me avoll
Numri i helikave: 2
Shpejtësia: 14.0 nyje
Autonomia: 650 milje me 14,0 nyje
Ekujpazhi: 35 vetë (version gjerman)
Armatimi: 1 top – 88 mm (version gjerman)
"Tirana", "Saranda", "Durrësi" dhe "Vlora"
Motovedeta silurhëdhese të Klasit ELCO, prodhuar në SHBA 1916-17 nga "Electric Boat Co."

Tonazhi: 43,84 ton;
Përmasat:: gjatësia 24,40 m, gjerësia 3.71 m, peshkimi 1,30 m;
Motorat: dy motorra të tipit 2S Standard, me fuqi 343 kË;
Numri i helikave: 2
Shpejtësia: 15 nyje (maksimalja 17 nyje)
Autonomia: 600 milje (17 nyje) dhe 800 milje (14 nyje);
Ekujpazhi: 15
Armatimi: 1 top 76 mm dhe 1 mitroloz dygrykësh 6.5mm.

Ardhur në Itali në vitin 1917 dhe armatosur si pjesë e një pakete prej 24 mjetesh. Në vitin 1926 katër prej tyre u transferuan në Shqipëri. Në SHBA u prodhua si një motovedetë për lëshimin e silurave, por në Shqipëri nuk ishte e pajisur me silura. Shërbyen në Marinën Mbretërore deri në vitin 1939 kur u kapën nga italianët, por asnjëherë nuk u përfshinë në inventarin e Marinës Mbretërore Italiane. Mbas kapitullimit të Italisë u kapën nga gjermanët. Tre nga katër motovedetat mbijetuan gjatë luftës dhe në vitin 1945 u kthyen në shërbim të Shqipërisë, të cilat morën numrat e bordit MS-10, MS-11 dhe MS-12.

Jahti Mbretëror "Iliria" është një ish anije patrulluese franceze "Lamproie". "Lamproie" është një nga pesë anijet e klasit "Gardon" ndërtuar nga Normand, Le Havre, në vitin 1918. Në vitin 1919 iu vu emri "Cité d'Athens" dhe në vitin 1926 u klasifikua në jaht dhe iu vu emri "Ëhite Diamond". Në vitin 1938 u ble nga qeveria e Italisë, iu vu emiri "Iliria" dhe iu dhurua mbretit të Shqipërisë Ahmet Zogu I-rë. Me pushtimin e Shqipërisë nga Italia në prill 1939, u kap u riemërua "Iliria" dhe u përfshi në Marinën Mbretërore Italiane duke u klasifikuar si anije patrulluese. Në vitin 1939 ishte pjesë e një grupi prej 10 anijesh nën komandën e Ministrisë së Marinës. Gjatë Luftës së Dytë Botërore shërbeu si anije e mbështetjes së sistemit të fenerëve. Në vitin 1944 gjendej në Taranto të Italisë. Anija mbeti në Itali edhe mbas luftës dhe u kthye në skrap në qershor 1958.

Vijon në numrin e ardhshëm

** Ky material është një bashkëpunim me Kapitenin e Rangut të Dytë (Ret) Hartmut Ehlers, Forcat Detare Gjermane.*

Personeli i motovedetave të Marinës Mbretërore në Portin e Durrësit

Përforcimi i axhendës, gratë, paqja dhe siguria

MIMOZA GOLIKJA

Në nëntor, Programi I NATO-s, Shkenca për Paqen dhe Sigurinë (SPS), mbështeti dy aktivitete të dizajnuara për të përmirësuar zbatimin e Rezolutës së Kombeve të Bashkuara të Sigurimit Këshillit (UNSCR) 1325 dhe rezolutat e lidhura. Më shumë se 120 ekspertë ushtarakë dhe civilë nga aleatët dhe vendet partnere shqyrtuan mënyra për të ecur përpara me axhendën e Grave, Paqes dhe Sigurimin. Zbatimi i Rezolutës 1325 dhe Rezolutave të lidhura paraqesin një prioritet të rëndësishëm të politikës për NATO dhe vendet partnere. "NATO ka qenë në ballë në pasqyrat e saj të politikave në lidhje me Rezolutën 1325. Tani kyç është implementimi në vendet e veçanta anëtare dhe partnere", vëren Dr. Chantal de Jonge Oudraat, Presidente e Grave në Sigurinë Ndërkombëtare (Ëiis).

Vlerësimi i progresit: Fletënotim i 1325

Më 6 dhe 7 nëntor, në Uashington DC, u zhvillua një seminar për të krijuar një mjet për vlerësimin se si perspektiva gjinore janë të integruara në politikat e sigurisë kombëtare. Seminari ishte i dyti në serinë e tre seminareve të cilat përbëjnë projektin e njohur si "The 1325 NATO Scorecard: Integrimi Gjinor: Treguesit për zbatimin e Rezolutës 1325 dhe Rezolutat e lidhura me të".

Projekti është hartuar për të përcaktuar një sërë treguesish për vlerësimin në secilin nga katër fushat e përcaktuara në UNSCR 1325: parandalimin, pjesëmarrjen, mbrojtjen, si dhe lehtësim dhe shërim. Masat e zbatuara nga vendet dhe partnerët e NATO-s në kontekstin e Rezolutës ndryshojnë, duke e bërë të vështirë për të vlerësuar progresin, veçanërisht në kontekstin e NATO-s. Fletënotimi i rezolutës 1325 të NATO-s, do të vlerësojë se si NATO dhe vendet partnere kanë realizuar integrimin e përkatësisë gjinore në operacionet ushtarake. Rezultatet do të lehtësojnë standardizimin në trajnim, zbatimin dhe monitorimin, si dhe vlerësimin e Gruas, Paqes dhe Sigurisë në agjendën e misioneve dhe operacioneve të drejtuara nga NATO.

"Çfarë e bën këtë projekt unik është, se ai sjell së bashku njerëz nga sektorët e sigurisë dhe të shoqërisë civile. Shumë nga liderët e pranishëm të shoqërisë civile komentuan mbi këtë karakteristikë të veçantë të këtij projekti dhe ëorkshopi", tha Kathleen Kuehnast, drejtor i Qendrës për Çështjet Gjinore dhe Ndërtimi i Paqes në Institutin Amerikan për Paqe (USIP).

Ambasadori Catherine Russell, për Çështje Globale të Grave në Departamentin Amerikan të Shtetit, adresoi delegatët, ku përfshiheshin zyrtarë të NATO-s, Shtabit Suprem të Forcave Aleate në Evropë (SHAPE), Qendra nordike Gjinore për operacionet ushtarake, si dhe përfaqësues nga shoqëria civile. Seminari i parë u mbajt më 26 dhe 27 maj të vitit 2014 në Serbi, në Qendrën e Beogradit për Politika të Sigurisë. Rezultatet e projektit do të paraqiten në ëorkshopin e tretë dhe të fundit në Bruksel në vitin 2015. Ëorkshopet organizohen nga Ëiis së bashku me USIP dhe Qendra e Beogradit për Politikat e Sigurisë (BCSP). Projekti filloi në vitin 2013.

Gratë në ushtri, rëndësia e rekrutimit dhe mbajtjes

Më 11 dhe 12 nëntor, Programi SPS mbështeti një ëorkshop në "Rey Juan Carlos University" në Madrid, në Spanjë. Eventi filloi me një projekt të ri, të udhëhequr nga Australia dhe Spanja, i projektuar për të vlerësuar ndikimin e Rezolutës 1325 në forcat e armatosura të NATO-s dhe të vendeve partnere. Studiuesit ndoqën një analizë të plotë të Raporteve Kombëtare në pronësi të Shtabit Ushtarak Ndërkombëtar të NATO-s (IMS), Zyra e Këshilltarit Gjinor, që përmban të dhëna të paklasifikuara në pozitën e grave në Forcat e Armatosura të aleatëve dhe partnerëve të NATO-s. "Ky bashkëpunim shumë kombëtar do të mundësojë NATO-n dhe vendet e saj anëtare për të kuptuar rëndësinë kritike të rekrutimit dhe mbajtjes së grave në ushtritë e tyre", tha Elizabeth Broderick, Komisioneri i Diskriminimit Gjinor, Komisioni i të Drejtave të Njeriut Australian. "Bazuar në përvojën Australiane bashkëpunimi do të mundësojë kombet për të zhvilluar strategji më të mira praktike që të arrijnë barazinë gjinore në ushtritë e tyre dhe të cilat në fund të fundit do të bëjnë që ushtritë e tyre të jenë më të efektshme," shtoi ajo. Ky projekt do të zhvillojë mjetet për të analizuar të dhënat nga viti 2000-2013, duke identifikuar fushat ku NATO mund të përmirësojë qëllimet që ajo ndjek në zbatimin e Rezolutës 1325 dhe rezolutat e lidhura. Raporti do të përfshijë praktikat më të mira dhe rekomandimet. "Vlera e shtuar e këtij projekti është që institucionet e shoqërisë civile, si universitetet dhe subjektet e të drejtave të njeriut, po punojnë së bashku me një organizatë politike dhe ushtarake si NATO. Ky bashkëpunim paraqet një shumëzim të forcave për të gjithë aktorët e përfshirë në këtë projekt", komenton Jezusi Gil Ruiz, Këshilltar Gjinor IMS.

NATO do të publikojë rezultatet përfundimtare dhe parashtrimin e tyre në Kombet e Bashkuara në vitin 2015, me rastin e 15 vjetorit të Rezolutës 1325.

Mbështetja e vazhdueshme për Rezolutën 1325

Programi SPS po vazhdon mbështetjen e saj për Gratë e NATO-s, Paqen dhe axhendën e Sigurimit. Ajo ka lëshuar një thirrje për propozime për seminare, kurse trajnimi, dhe projektet që do të organizohen nga shkencëtarë, ekspertë dhe politikëbërës nga vendet e NATO-dhe vendet partnere për të mbështetur zbatimin e Rezolutës 1325 dhe rezolutat e lidhura.

"Shoqëria civile ka treguar në mënyrë të përsëritur angazhimin e saj dhe udhëheqjen në këtë fushë", komenton Michael Gali, këshilltar i lartë në NATO. "Unë prandaj shpresoj se ne mund të vazhdojmë të zhvillojmë mundësi, si këto ëorkshope, që sjellin së bashku një gamë të larmishme të ekspertëve. NATO dhe partnerët e saj besojnë në rolin kryesor që gratë mund të luajnë në ndërtimin, konsolidimin dhe ruajtjen e paqes dhe sigurisë. Programi SPS NATO punon për të mbështetur këto përpjekje".

Programi SPS është një mjet i partneritetit të NATO-s në Sfidat e dala në Divizionin e sigurisë së NATO-s. Programi SPS është një mjet i partneritetit në Divizionin e Sfidave të Dala të Sigurisë së NATO-s.

Armët kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore (CBRN), janë ndër armët më të rrezikshme në botë. Disa grupe terroriste janë përpjekur në mënyrë aktive që me armët e shkatërrimit në masë, të mund të shkaktojnë një mortalitet më të lartë se sa me armët konvencionale. Është e rëndësishme për të siguruar që reagimi i parë është përgatitur për të tilla raste dhe që vendimmarrësit të marrin në kohë informacion shkencor dhe operativ CBRN për të mbrojtur popullatat. Në mënyrë për të menaxhuar efektivisht pasojat e incidenteve CBRN, një kurs trajnimi për reagimin e parë u zhvillua në Qendrën e Përbashkët CBRN të Mbrojtjes së Përsosmërisë në Vyškov, në Republikën Çeke më 12 nëntor 2014. Tridhjetë ushtarakë dhe civilë pjesëmarrës nga strukturat menaxhimit të pasojave të Azerbajxhanit, Moldavisë, Ukrainës dhe vendeve të NATO-s morrën pjesë në kurse të titulluara "Menaxhimi i Pasojave pas incidentit të CBRN".

Qëllimi kryesor i kursit ishte të sigurojë që reagimi i parë, i tillë si i oficerëve të policisë, zjarrfikësve dhe ndihmës së shpejtë, kanë një bazë të përbashkët të njohurive dhe një nivel bazë të gatishmërisë për tu përgjigjur ndaj incidenteve të CBRN. Përzierja e teorisë me praktikën, natyrisht u fokusua për të ndihmuar vendet që të përmirësojnë planet e tyre të emergjencës civile dhe në kërkim, si dhe si NATO, Bashkimi Evropian dhe organizata të tjera ndërkombëtare organizojnë sistemet e tyre pasojë-menaxhimi.

Incidenti i vitit 2011 në centralin bërthamor në Fukushima, për shembull, u shqyrtua nga afër, dhe ekspertët të cilët ndihmuan marrëveshjen me incidentin gjithashtu morrën pjesë në kurs.

Përkujtohet 20 vjetori i Dialogut Mesdhetar në Aman të Jordanisë

Këshilli i Atlantikut të Veriut: Dialogu Mesdhetar, "më i rëndësishëm se kurrë"

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, 28 Përfaqësuesit e Përhershëm të Këshillit të Atlantikut të Veriut dhe Kryetari i Komitetit Ushtarak, gjenerali Knud Bartels, kujtuan 20 vjetorin e Dialogut Mesdhetar më 9 dhjetor 2014 në Aman, Jordani. Ata u bashkuan me ambasadorët e shtatë vendeve, (Algjeri, Egjipt, Izrael, Jordani, Mauritani, Marok dhe Tunizi), që marrin pjesë në forumin e partneritetit. Në një botë të paqëndrueshme, "siguria e vendeve të NATO-s është e lidhur ngushtë me sigurinë dhe stabilitetin në Mesdhe dhe në Lindjen e Mesme", tha Sekretari i Përgjithshëm gjatë një seminari të veçantë për nder të përvjetorit. "Kjo e bën Dialogun Mesdhetar më të rëndësishëm se kurrë".

Gjatë seminarit Sekretari i Përgjithshëm përcaktoi tre fusha ku pa hapësirë për rritjen e bashkëpunimit me partnerët e Dialogut Mesdhetar. Ai tha se NATO do të mund tu ofrojë partnerëve më shumë ndihmë në sektorët e mbrojtjes dhe të sigurisë dhe bëri thirrje për rritjen e aftësisë së forcave të armatosura që të punojnë së bashku, si dhe për konsultime më të thella politike. "Partneriteti ynë është i fortë, le të bëjmë atë më të fortë", tha Stoltenberg.

Sekretari i Përgjithshëm mbajti gjithashtu bisedime me ministrin e jashtëm jordanez Nasser Judeh, për të diskutuar sfidat aktuale të sigurisë në Lindjen e Mesme dhe bashkëpunim më të ngushtë. Ai falënderoi Jordaninë për të pritur takimin e Dialogut Mesdhetar. Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu tha se Aleanca ishte mirënjohëse për vendimin e Jordanisë për të qenë pjesë e Forcës së Reagimit të NATO-s si një komb partner. Ai tha se aleatët kanë qenë mirënjohës për kontributet që ka bërë Jordania për stabilitetin rajonal dhe për partneritetin që ka me NATO-n. Stoltenberg tha gjithashtu se NATO është gati "për të ndihmuar Jordaninë kur vjen puna për të, për shembull, të mbrojtjes kibernetike, por edhe kur vjen puna për të llojet e ndryshme të ushtrimeve. Ne kemi rënë dakord për të zhvilluar këtë lloj të bashkëpunimit edhe më afër". Gjatë vizitës së tyre në Aman, Sekretari i Përgjithshëm dhe ambasadorët patën një audiencë me Madhërinë e Tij Mbretin Abdullah II. Stoltenberg dhe 28 Përfaqësuesit e Përhershëm të Këshillit të Atlantikut të Veriut diskutuan sigurinë rajonale dhe bashkëpunimin NATO-Jordani gjatë bisedimeve me Madhërinë e Tij Mbretit Abdullah II, më 10 dhjetor 2014. Ata diskutuan me Madhërinë e tij Mbretin, sfidat e sigurisë aktuale, përfshirë kërcënimin e terrorizmit dhe ekstremizmit. Stoltenberg shprehu mirënjohjen e NATO-s për partneritetin e vazhdueshëm të ngushtë të Jordanisë, në Dialogun Mesdhetar. Ai falenderoi gjithashtu Mbretin për përpjekjet e Jordanisë për të rritur sigurinë dhe stabilitetin rajonal, dhe tha se Aleanca pret rritjen e partneritetit me Jordaninë, përfshirë përpjekjet për të rritur ushtrimet e përbashkëta dhe rritjen e aftësive. Sekretari i Përgjithshëm zhvilloi gjithashtu bisedime me kryeministrin jordanez dhe ministrin e Mbrojtjes Dr. Abdullah Ensour, si dhe u takua veçmas me ministrin e jashtëm Nasser Judeh.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s përshëndet partneritetin e Gjirit në Katar

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg bëri thirrje për bashkëpunim më të thellë politik dhe praktik me partnerët e Gjirit në një vizitë në Doha, Katar, ditën e enjte më 11 dhjetor 2014. Sekretari i Përgjithshëm dhe ambasadorët e 28 vendeve të NATO-s u bashkuan me 4 partnerët e Iniciativës së Stambollit për Bashkëpunim (Bahreini, Katari, Kuvajti dhe Emiratet e Bashkuara Arabe) në një seminar për të shënuar përvjetorin e dhjetë të këtij partneriteti.

"Marrëdhëniet NATO-s me partnerët e saj të Gjirit janë bërë më të thella dhe më të forta", tha Sekretari i Përgjithshëm. "Sa më shumë që ne të bashkëpunojmë, aq më të sigurt ne do të jemi".

Seminari Këshilli i Atlantikut të Veriut - Iniciativa e Bashkëpunimit të Stambollit, po mbahet jo vetëm për të festuar dhjetë vjetorin e partneritetit, por edhe për një diskutim të sfidave të përbashkëta të sigurisë (përfshirë terrorizmin dhe ekstremizmin, sigurinë detare, si dhe sigurinë në internet) dhe mënyrat e mundshme për t'i adresuar ato së bashku. Ambasadorët do të diskutojnë mbi ecurinë e partneritetit deri më sot dhe atë në të ardhmen. Konferenca e së enjtes pasoi vizitën e Këshillit të Atlantikut të Veriut në Aman, të Jordanisë në përvjetorin e njëzetë të partneritetit të Dialogut Mesdhetar.

Përgatitja për reagimin e parë për incidentet CBRN

Ballafaqimi me shërimin

"Shumë njerëz do të preken dhe shumë subjekte do të merren me rimëkëmbjen", tha kapiteni Gorazd Stergar, në kursin e mbrojtjes në CBRN, instruktor në KE JCBRN të Mbrojtjes. "Dhe për këtë duhet të jemi gati. Ky kurs ofron mundësi se si dhe ku mund të gjeni zgjidhjet e mundshme, secili incident CBRN është unik", shtoi ai. Menaxhimi i pasojave është një përgjegjësi kombëtare dhe çdo shtet është përgjegjës për trajtimin e emergjencave që ndodhin brenda territorit të tij. Megjithatë, duke iu përgjigjur incidenteve, CBRN përfshin shumë organizata dhe agjenci si asnjë agjenci tjetër civile ose ushtarake, posedon kapacitet dhe ekspertizë për të trajtuar shumë çështje komplekse që mund të lindin vetëm në përgjigje të incidenteve CBRN.

Promovimi i sigurisë

Bashkëdrejtor i këtij projekti është kolonele Mariana Grama, nga ministria e Mbrojtjes së Republikës së Moldavisë, vendi i së cilës po përballet me çështje të sigurisë në këtë zonë. "Ka shumë objekte CBRN të rrezikuara që u mungon mbrojtje fizike dhe po paraqesin një rrezik të lartë për sigurinë tonë kombëtare, shëndetin publik dhe mjedisin", tha kolonele Grama. "Ka gjithashtu një rritje të agjentëve CBRN, të importuara në vend ose tranzituara nëpër territorin tonë dhe kemi të bëjmë me jostabilitet në vendet fqinje, në mënyrë të veçantë me Ukrainën", vazhdoi ajo. Në të ardhmen, kolonele Grama shpreson se ajo do të jetë në gjendje të integrojë atë që është mësuar në planifikimin e tyre kombëtar menaxhim-Krizë". Kjo do të jetë më e lehtë dhe më efikase për të përmirësuar ndërveprimin midis ekipeve të reagimit në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare dhe për të rishikuar dhe përmirësuar planet operative CBRN dhe veprime në vend, me integrimin e standardeve dhe procedurave ndërkombëtare, sidomos ato të BE-së dhe NATO-s", shpjegoi kolonele Grama. Në lidhje me një koordinim më të madh, oficeri i Shërbimit të Sigurimit të Ukrainës Andrii Vasylyshyn, i cili mori pjesë në kurs, deklaroi: "Proceset e vazhdueshme të sotme të globalizimit po ndryshojnë natyrën e luftës së bashku me rritjen e kërcënimit nga grupet globale, në rrjet, të decentralizuara dhe jepen nga terroristë të cilët janë të përgatitur për të përdorur materiale CBRN jo më si një mjet për të arritur objektiva politike, por si një qëllim në vetvete". Ai shtoi se, "ka një nevojë në rritje për të mbrojtur shoqërinë nga skenarë të mundshëm në të ardhmen, në të cilën materiale CBRN mund të dislokohen me anë të pazakonta të shpërndarjes. Kjo do të kërkojë bashkëpunimin mes qeverive, zyrtarëve të kundër-terrorizmit dhe të agjensive të kundër-përhapjes".

Shkëmbimi i informacionit mbi kërcënimet CBRN dhe rreziqet

Përveç këtij kursi trajnimi, Qendra Mbrojtjes JCBRN inauguroi gjithashtu më 12 nëntor qendrën e parë CBRN mbështetëse të NATO-s. "Ajo ofron ekspertizë CBRN, në kohë shkencore dhe operative, vlerësime dhe këshilla për komandantët e NATO-s dhe të personelit të tyre në të gjithë spektrin e plotë të operacioneve", tha Jamie Shea, zëvendësndihmës i Sekretarit të Përgjithshëm për zhvillim të Sigurisë e Sfidat e NATO-s. Dhoma e operacioneve e vendosur në Qendrën e Mbrojtjes JCBRN do të lejojë komandantët e NATO-s për të mbrojtur forcat e dislokuara dhe të sigurojë ekspertë me këshilla CBRN, për të ndihmuar në mbrojtjen e popullatës civile të vendeve anëtare. Me pak fjalë, kjo do të rrisë gatishmërinë CBRN dhe aftësitë në reagimin e parë të NATO-s. "Një sistem gjithëpërfshirës informacion-grumbullimi dhe vlerësim i informimit janë aspekte thelbësore të inteligjencës dhe mbrojtjes CBRN", tha koloneli Jiri Gajdos, drejtor i JCBRN i Mbrojtjes COE. Kjo është vendimtare për një vlerësim të besueshëm të aktiviteteve, siç përjetohet gjatë CBRN, keqpërdorimit nga grupet terroriste në Afrikën Veriore dhe Lindjen e Mesme, apo pasojat e incidenteve industriale të tilla si ato të Çernobilit ose në Fukushima. Dhoma e operacionit është tashmë në gjendje për t'iu përgjigjur kërkesave kombëtare dhe të NATO-s për informacion mbi bazën 24/7 dhe mund të zhvendoset lehtë në mënyrë operacionale, në shfaqen e krizës. Struktura e saj është përfshirëse e të dy autoriteteve të pasojë-menaxhimit, ushtarak dhe civile. Kërkesa për qendrën mbështetëse CBRN është një nga mësimet e nxjerra nga operacionet e NATO-s dhe është identifikuar si një aftësi kritike për operacionet e ardhshme në një mjedis të mundshëm CBRN. Kursi është financuar në kuadër të Shkencës të NATO-s për Programin (SPS) Sigurimit të Paqes dhe i sponsorizuar nga Mbrojtja e NATO-s kundër terrorizmit, Programi i Punës (DAT Poë), i cili synon për të zbutur mungesat kritike të aftësive të Aleancës.

Teknikët e inxhinierët e Regjimentit të Kuçovës, novatorë të Aviacionit Shqiptar

FILLOTA KORUNI, specialist dhe veteranë i aviacionit*

TEKNIKËT DHE INXHINIERËT

Do të mbetet e paharruar puna plot përkushtim e profesionalizëm i asaj plejade të lavdishme inxhinierësh e tenikësh, që së bashku me atë avangardë pilotësh të talentuar i dhanë krenarinë dhe lavdinë Aviacionit Luftarak Shqiptar për disa dekada me radhë

Pas shumë eksperimentimeve të karburantit tonë, firmosur nga inxhinieri i aviacionit S. Kagjini, në prill të vitit 1961 kolonel Niko Hoxha fluturoi për herë të parë në qiellin shqiptar me aeroplanin Mig-15 me vajgurin e markës shqiptare. Ishte një arritje e madhe jo vetëm për aviacionin, por edhe për ekonominë e vendit tonë

Historia e aviacionit ushtarak shqiptarë është e mbushur me plot ngjarje të lavdishme, të cilat kanë si emerues të përbashkët punën, sakrificat dhe heroizmin e personelit fluturues dhe inxhiniero-teknikë të kësaj arme që për shumë vite ishte krenaria e ushtrisë shqiptare. Por nëse për personelin fluturues, pilotët tanë trima dhe sypatrembur është shkruar jo pak, për pjesën tjetër po kaq të rëndësishme, personlein inxhiniero-teknik të aviacionit, për ata që përgjigjeshin për sigurinë teknike të avionëve në fluturim, është shkruar pak. Pikërisht për të përmbushur sado pak këtë boshllëk në këtë shkrim do të flasë për punën dhe kontributin e tyre në ish-regjimentin e parë të aviacionit shqiptar, atë të Kuçovës.

Që në krye të herës dua të nënvizoij se një rol parësor në sukseset e arritura ndër vite nga Regjimenti i Kuçovës në mbajtjen dhe forcimin e gatishmërisë luftarake etj., ka pasur efektivi inxhniero-teknik, i cili ka siguruar fluturimet në të gjitha kushtet e motit pa premisa për ngjarje, likujdimin në kohë të difekteve të ndodhura gjatë fluturimeve, si dhe riparimet e kryera në kohë nga ofiçina e riparimit të aeroplanëve. Është për t'u theksuar se efektivat e para të këtij sektori të rëndësishëm dhe me përgjegjësi, ishin teknikët e parë që krijuan aviacionin shqiptar të shkolluar në vitet 1945-1951 në ish-Jugosllavi apo ish-Bashkimin Sovjetik (BS) dhe që kishin fituar eksperiencën në aerodromet sovjetike në vitet 1949 -1951, si dhe përvoja e fituar nga skuadrilja autonome Jak-9P në vitet 1951-1954. Pjesa e përzgjedhur e teknikëve të lartpërmendur (ish-partizanë të LANÇ) me baza arsimore gjimnaz apo lice, së bashku me një grup të rinjsh nga shkolla ushtarake "Skënderbej" dhe nga shkolla e parë e mekanikëve të aviacionit e krijuar në skuadriljen autonome Jak-9P, nga viti 1952-1954 shkuan në BS për t'u specializuar për aeroplanin Mig-15 dhe pas kthimit në Shqipëri së bashku me grupin e pilotave, krijuan më 15 maj 1955 Regjimentin e Kuçovës. Ja pra, ky ishte efektivi inxhiniero-teknik, emrat e të cilëve i kam përmendur në hyrje të këtij kapitulli..... Ky efektiv ishte i ndërgjegjshëm për përgjegjësinë e madhe që kishte ndaj atdheut, por edhe para efektivit fluturues. Rëndësi të madhe i kushtoi jo vetëm teknikës fluturuese, por edhe materialeve të konsumit, siç ishin karburantet, vajrat speciale të lubrifikimit, pjesët e këmbimit, gominat apo guarnicionet, gomat (rrotat e avionëve) apo ferrotat e frenimit etj. Të gjitha këto ishin materiale importi në atë kohë dhe me një kosto të lartë financiare.

Shkurtimisht po përmend disa arritje të këtij efektivi në ato vite:

1-Krijimi i një pajisje për të kontrolluar hermetizimin e rezervuarëve varës të karburantit kur ata vendoseshin në aeroplan. Para krijimit të kësaj pajisje hermetizimi kontrollohej nëpërmjet lëshimit të motorave të aeroplanit. Pra harxhohej 150-200 litra vajguri për një lëshim, por sa herë hiqeshin dhe vendoseshin këta rezervuarë në aeroplan? Nuk mund ta imagjinoni! Në çdo fluturim rezervuarët hiqen apo vendoseshin sipas kriterit të detyrave. Kështu, p.sh, në fluturimet "marshut", rreth territorit të vendit apo në gatishmëri, ata fluturojnë me rezervuar varës, kurse në "zonë", luftim ajror në poligon, kapje etj., ata fluturojnë pa rezervuar. Me krijimin e kësaj pajisje u hoq lëshimi i motorave.

2-Krijimi i një pajisjeje për vendosjen e konusit në aeroplanin Jak-11 (për tërheqjen e konuseve) që do të shërbente për stërvitjen e reparteve të artilerisë kundërajrore të ushtrisë sonë. Ky aeroplan e ka kryer këtë detyrë nga viti 1954 deri në vitin 1957. Me ardhjen e Bombarduesit IL-28, kjo detyrë u krye nga ai. Me të dy këta aeroplanë ka fluturuar piloti Barjam Hita.

3-Krijimi i një fonderie duralumini për të prodhuar majat e fishekëve të provës së topave 23 dhe 37mm (që vendoseshin gjatë qitjes për të mos prishur fishekë luftarakë).

4-Krijimi i bangoprovave për kontrollin dhe riparimin e gjeneratorëve të aeroplanëve Mig-15.

5-Krijimi i një bangoprove për kontrollin e armëve të artilerisë së avionit Mig-15.

6-Vendosja e parashutës frenuese në aeroplanin Mig-15, që bënte të mundur shkurtimin e distancës së uljes në pistë. si dhe ulja në aerodromet e pa betonuara, si në Lumalas të Korçës, Cërrik, Pishporo dhe fusha e Shtojit (Shkodër) Eksperimentimi (ulja në fushë, duke përdorur parashutë frenuese), u krye nga piloti dhe komandanti i paharruar kolonel Niko Hoxha.

Disa prej këtyre arritjeve dhe vlerat ekonomike të tyre janë publikuar në organet shtypit ushtarak të asaj kohe, në gazetën "Luftëtari", revistën "10 Korriku" etj. Po në vitin 1958, kur intensiteti i fluturimeve u rrit në mënyrë galopante (u hap shkolla e parë e pilotëve fillestarë dhe filluan fluturimet në avionin Mig-15), në teknikën fluturuese lindën probleme. Shumë aeroplanëve iu tejkaluan resurset teknike të fluturimit, mbi 250-300 orë fluturimi dhe i duhej kryer riparim i mesëm. Këto punime kryheshin në uzinat e aviacionit që ne nuk i disponoonim në atë kohë. Pra me një fjalë, avionët që kishin kaluar resursin, duhej të adresoheshin jashtë shtetit për riparim. Në këtë situatë problematike për gatishmërinë e teknikës fluturuese, seksioni inxhiniero-teknik i Regjimentit krijoi një grup pune i përbërë nga inxhinierët: Stefan Kagjini, Kiço Mëhilli, Petrika Manastirliu, Nexhip Manushi etj. Pas studimit të literaturës teknike, bazuar në eksperiencën disa vjeçare të efektivit inxhiniero-teknik, grupi doli me konkluzionin se janë të gjitha mundësitë që riparimi i mesëm mund të kryhej në ofiçinën e Regjimentit. Për ta realizuar këtë riparim të mesëm, u vunë detyrat që të krijohej teknologjia dhe të bëheshin kartat teknologjike, ndërkohë u krijuan një seri pajisjesh apo bangoprova dhe kështu filloi riparimi i mesëm i aeroplanit Mig-15. Aeroplani i parë që iu krye riparimi, fluturoi në qershor të vitit 1959 dhe ky riparim vazhdoi deri në vitin 1968 kur u ndërtua Uzina e Aviacionit të Kuçovës. Por kjo lëvizje novatore tekniko-shkencore u thellua në mënyrë të veçantë pas prishjes së marrëdhënieve me BS. Një nga përpjekjet shkencore më të suksesshme të atyre viteve ishte prodhimi në vend i karburantit të avionëve reaktivë. Detyra për zgjidhjen e këtij problemi jetik për aviacionin erdhi nga lart. Në dhjetor të vitit 1960, komandanti i regjimentit Niko Hoxha mblodhi seksionin inxhiniero-teknik, si dhe teknikët dhe inxhinierët e ofiçinës së riparimit dhe u parashtroi detyrat për prodhimin e karburantit. Për zgjidhjen e këtij problemi u krijuan dy grupe pune:

1-Grupi i aviacionit, i drejtuar nga kryeinxhinieri i aviacionit Stefan Kagjini, si dhe specialistët të avio-motorit Nexhip Manushi dhe Nasi Themeli.

2-Grupi i naftëtarëve i përbërë nga inxhinierët e naftës Petrika Ballauri, Koço Pepo dhe Llazar Kreshpani.

Problem primar i këtij studimi ishte formula bazë e vajgurit të markës TS-1, elementët bazë të tij etj. Në ato vite në literaturën teknike zakonisht këto formula nuk jepeshin, konsideroheshin sekrete. Por inxhinieri i aviacionit S. Kagjini, duke shfrytëzuar literaturën ekzistuese, dijenitë që kishte marrë në shkollat apo akademitë e aviacionit për problemet e karburanteve, ishte optimist se edhe nafta e vendit tonë mund të realizohej për prodhimin e vajgurit TS-1. Puna intensive e të dy grupeve dhe bashkëpunimi ndërmjet tyre, bëri të mundur që inxhinierët e naftës ta prodhonin vajgurin. Por vajguri duhej të provohej në motorat reaktivë. Për këtë u bënë provat në dy motorë, duke përdorur karburantin e prodhuar nga naftëtarët tanë, si dhe të sovjetikëve. Këto prova u bënë me dhjetëra herë. Stefan Kagjini me shokët e tij, Nexhip Manushi dhe Nasi Themeli, zbërthyenë motorat dhe kontrolluan agregatet, si pompat, dhomat e djegies, lopatat e turbinës etj. Rezultatet e këtyre eksperimenteve dolën me sukses. Cilësia e karburantit të prodhuar nga naftëtarët ishte e njëllojtë me atë të sovjetikëve. Pas shumë eksperimentimeve të karburantit tonë, firmosur nga inxhinieri i aviacionit, S. Kagjini, në prill të vitit 1961 kolonel Niko Hoxha fluturoi për herë të parë në qiellin shqiptar me aeroplanin Mig-15 me vajgurin e markës shqiptare. Ishte një arritje e madhe jo vetëm për aviacionin, por edhe për ekonominë e vendit tonë.

Puna krijuese dhe novatore e efektivit inxhiniero-teknik të Regjimentit të Kuçovës, ka luajtur një rol të rëndësishëm jo vetëm në mbajtjen në gatishmëri të teknikës fluturuese, por edhe në kursimin e vlerave të mëdha monetare e finaciare. Gjithashtu, në atë kohë ajo hapi rrugën për krijimin e një tradite në këtë fushë, u bë burim frymëzimi dhe këto tradita të shkëlqyera të regjimentit tonë, nëpërmjet specialistëve dhe kuadrove të tij, ua transmetuan reparteve të tjera të aviacionit, që u krijuan më vonë dhe që do ta ngrinin më lart lavdinë e aviacionit shqiptarë.

Po si u vlerësua puna shkencore e kryeinxhinierit të aviacionit tonë (së bashku me bashkëpunëtorët e tij), i cili vuri të gjitha energjitë e tij mendore dhe fizike dhe mori përgjegjësinë mbi vete që turbinat tona të aviacionit të fluturonin në ajër me vajgurin e prodhuar nga naftëtarët tanë? Me keqardhje, por duhet thënë se si për shumë studime edhe për këtë studim madhor, që ishte në rang kombëtar, si për mbrojtjen dhe për ekonominë, nuk u dhanë vlerësimet e duhura nga Komanda e Aviacionit, Mbrojtja Kundërajrore apo Ministria e Mbrojtjes, në një kohë që në atë periudhë në përvjetorët e festave apo jubileve të ndryshme nga shteti ynë bëheshin vlerësime në fushën e teknikës, të shkencës, të bujqësisë, artit, industrisë mekanike, minierave etj, duke i dhënë dekorata, çmime apo tituj shkencorë individëve të ndryshëm për studimet e tyre në fushat që përmendëm më lart. Pavarësisht nga mos akordimi apo dhënia e këtyre çmimeve nga organet që e kishin në dorë, ky studim do të mbetet në historinë e aviacionit si një nga arritjet më të mëdha jo vetëm për ushtrinë, por edhe ekonominë e vendit tonë. Ashtu siç do të mbetet e paharruar puna plot përkushtim e profesionalizëm të lartë i të gjithë asaj plejade të lavdishme inxhinierësh e tenikësh, që së bashku me atë avangardë pilotësh të talentuar i dhanë krenarinë dhe lavdinë Aviacionit Luftarak Shqiptar për disa dekada me radhë.

** Fillota Koruni ka mbaruar për teknik aviacioni në ish-BS në vitin 1950. Ka punuar si teknik aviacioni për mëse 30 vjet në disa baza ushtarake tw aviacionit shqiptar. Ai njihet si një ndër treknikët më të specializuar në fushën e aviacionit, duka pasur përplasje me disa nga ish ushtarakët e lartë të atij sistemi. Eshtë njohur për seriozitet në punë, për korrektësi dhe profesionalizëm të lartë.*

Makina e parë llogaritëse në shërbim të luftës

Konrad Zuse ndërtoi në vitin 1941 kompjuterin e parë funksional në botë

Njerëzimi ka ecur përmes zhvillimeve të shumta përgjatë gjithë historisë së tij mijëra vjeçare. Shpikjet e mendimit njerëzor janë të shumta dhe ato kamë përcaktuar shkallët e zhvilimit dhe madje kanë përmbysur epoka. Kështu p.sh., Thomas Edison shpiku llampën elektrike, duke sfiduar errësirën dhe dritën gjysmake të qirinjëve, vëllezërit Ërright qenë të parët që u ngritën nga toka me avionin e tyre të motorizuar, për të hapur rrugët e transportit qiellor...Po kompjuterin, këtë "çudi" të shekullit kush e ka shpikur? Gjykatat për patentimin i janë përgjigjur këksaj pyetjeje me emrin: "Charles Babbage". Anglezi ka patur idenë e parë që në shekullin e 19-të. Por kompjuterin e parë funksional në botë e ndërtoi Konrad Zuse në vitin 1941, në dhomën e ndenjës së prindërve të tij në Berlin. Ky kompjuter ishte në gjendje të ruante 64 fjalë.

Konrad Zuse lindi 104 vjet më parë me 22 qershor 1910. Ai është shpikësi gjenial, që ndërtoi kompjuterin për të kryer më lehtë përllogaritjet, siç pat thënë ai vetë në një intervistë në vitin 1992. "Unë kam studjuar inxhinieri ndërtimi. Dhe inxhinieri i ndërtimit duhet të bëjë edhe llogari statike, që i kushtojnë shumë mund dhe llogaritje të pafund. Unë kërkoja rrugët, për t'i automatizuar këto llogaritje dhe në fund arrita në një koncept dhe në fund tek ai që ne sot e quajmë "Computer". Të gjithë këtë kam mundur ta zhvilloj si rezultat i profesionit tim".

Konrad Zuse përdori llamarina, leva dhe shufra për kompjuterin e tij "Z 1" apo "Zuse 1" të vitit 1938. Për inxhinierin e ndërtimit ai ishte atëherë vetëm një model prove, që kishte mjaft gabime. Pas tij pasoi një tjetër model prove, "Z 2", dhe ai kishte një kalim telefoni. Në vitin 1941 pasoi kompjuteri i parë funksionues i botës, legjendari "Z 3".

Kalkulatori përbëhej nga 600 rele telefonike dhe kishte formën e një rafti gjigand. Sot kjo makineri ndodhet në muzeun gjerman në Mynih. Heinz Molter informon vizitorët për hollësitë në lidhje me "Z 3" dhe u përgjigjet pyetjeve. "Njerëzit qëndrojnë të habitur para makinës dhe e mbajnë për diçka tjetër nga ç'është në të vërtetë. Bëjnë pyetje nga më interesantet. Javën e kaluar, p.sh, më pyeti një freak, nëse makina mund të lidhej me internetin dhe përgjigja ime ishte: Nëqoftëse keni afro 28.000 vite kohë, mund ta bëni.", tregon Molter.

Konrad Zuse nuk ndërtoi atë, që sot quhet "Hardware". Për të vënë në veprim kompjuterin atij i duhej një program, apo një Software: "Makinë llogaritëse". Udhëzimet dhe shifrat jepeshin përmes shiritave me vrima dhe duhej të llogariteshin pastaj nga makina.

Shumë shpejt Konrad Zuse e kuptoi universalitetin e makinës së tij llogaritëse. Zuse nuk ishte anëtar i Partisë Punëtore Nacional Socialiste gjermane (NSDAP) dhe kompjuterin e tij nuk e zhvilloi me porosi të nazistëve. Por, megjithatë ai e vuri makinën e tij llogaritëse në shërbim të luftës: Për ndërtimin e avionëve të rinj, për deshifrimin e mesazheve të koduara të aleatëve. Por për të vetë, - kështu tregonte më vonë shpikësi, - kjo ka qenë në radhë të parë një detyrë shumë interesante dhe mahnitëse nga ana teknike.

> *Pak muaj para vdekjes, Zuse i dhuroi themeluesir të Microsoftit Bill Gates tablonë e panairit të kompjuterit në Hanover, e cila qëndron varur edhe sot në zyrën e tij*

Pas përfundimit të luftës në Gjermani nuk nevojiteshin kompjuter. Në plan të parë ishte rindërtimi. Por Konrad Zuse mbeti vizionar. "Unë e kisha të qartë, se kam hyrë në një botë rë re të llogaritjes dhe besoja se loja e shahut është një fushë shumë e përshtatshme, për të krijuar një gjuhë algoritmike, siç themi sot. P.sh, në vitin 1938 unë kam thënë me shaka në rrethin e miqve të mi se në vitet 50 kampioni botëror i shahut do të mundet nga një makinë llogaritëse. Për fat të keq nuk doli krejtësisht ashtu, po tendenca ka qenë pa dyshim e saktë."

Në vitin 1944 krijoi modelin Z4 Zuse, por ai u shit në vitin 1950 në Zürich. Atje konkurrenca kishte ecur përpara, sidomos nga firma IBM: fillimisht me llampa dhe pastaj me tranzistorë. Që në vitin 1940 Zuse kishte themeluar një firmë të veten "Ndërtimi i aparaturave Zuse", por 25 vjet më vonë, 1964, sipërmarrja familjare e tij falimentoi. Si humbjen më të madhe Zuse përjetoi grindjen me gjyqin për patentimet. Në sytë e tij Zuse ishte shpikësi i kompjuterit, por Zuse nuk u quajt "shpikësi i kompjuterit". Ky ishte një zhgënjim i madh. Që vendimi nuk ishte në rregull e shihte edhe i verbri.

Në vitet '60-të, pas falimentimit të firmës së tij, Konrad Zuse u tërhoq dhe filloi të pikturonte. Por edhe ketu kompjutetrat nuk e lëshuan. Ai bëri portretet e pionierëve të kompjuterave, ndër to themeluesin e Microsoftit, Bill Gates. Në 1995, pak muaj para vdekjes së tij, Zuse i dhuroi amerikanit tablonë e panairit të kompjuterit në Hanover. Ai qëndron i varur në qendrën e firmës në Seattle, në zyrën e Bill Gates.

Përgatiti Albert Zholi

NJOFTIM

Për kriteret e përgjithshme për rekrutimin e ushtarëve/ detarëve aktiv:

a). Për t'u rekrutuar në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë si ushtar/detar aktiv shtetasit shqiptarë duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale;
- Të mos jetë në ndjekje penale;
- Të mos ketë humbur të drejtën e ushtrimit të profesionit ose veprimtarisë në administratën publike me vendim gjykate;
- Të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata;
- Mosha minimale e rekrutimit është 18 vjeç. Në momentin e titullimit ushtar/detar aktiv, nuk duhet të kenë mbushur moshën 27 vjeç. Përjashtim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen ushtar/detar aktiv, të cilët do të jenë personel mjekësor i Forcave të Armatosura dhe në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç;
- Të ketë kryer arsimin parauniversitar ose të lartë brenda ose jashtë vendit;
- Të ketë kryer kontrollin shëndetësor dhe të jetë vlerësuar i aftë për ushtar/detar aktiv nga Spitali Ushtarak i FA në Komandën Mbështetëse;
- Të ketë kaluar testin fizik, intelektual dhe psikologjik;
- Kandidatët për ushtar/detarë aktiv të kenë gjatësinë trupore mbi 170 cm për meshkujt dhe mbi 165 cm për femrat;
- Kandidatët për ushtar aktiv të planifikuar për kompletimin e Policisë Ushtarake duhet të kenë gjatësinë trupore mbi 170 cm për meshkuj dhe femra.

b). Për rekrutimin sipas specialiteteve të veçanta, veç këtyre kritereve të aplikohen edhe kritere specifike për aftësitë profesionale dhe parametrat fizikë, të cilat përcaktohen me një udhëzim të veçantë të SHSHP.

Procedura e aplikimit për ushtar/detar aktiv:

a) Shtetasit që dëshirojnë të shërbejnë në Forcat e Armatosura si ushtar/detarë aktiv do të aplikojnë drejtpërdrejtë në zyrën e pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit.

b) Aplikantët plotësojnë formularin e aplikimit dhe pranimit të dokumentacionit (bashkëlidhur këtij udhëzimi) dhe marrin njoftimin për dokumentet e nevojshme, afatin e paraqitjes në Qendrën e Personel Rekrutimit për vijimin e procesit të pranimit, testimit e përzgjedhjes.

c) Procedurat, kriteret, rregullat e testimit bëhen publike në faqen e internetit të Forcave të Armatosura.

Regjistrimi i kandidatëve, dokumentacioni i nevojshëm:

a) Kandidatët për ushtar/detar aktiv paraqesin në Qendrën e Personel Rekrutimit dokumentet e mëposhtme:
- Kërkesë me shkrim, në të cilën parashtrohet identiteti i aplikantit, statusi familjar (martuar, beqar), arsyet për të cilat dëshiron të bëhet ushtar/detar aktiv, njësia apo reparti në të cilin do të dëshironte për të shërbyer. Aftësitë, përvoja në punë, prirjet e tij në fusha të caktuara, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi (formulari i aplikimit);
- Fotokopjen e kartës së identitetit;
- Certifikatë familjare;
- Dy fotografi të përmasave 4 x 6cm dhe dy fotografi të përmasave 9x12 cm;
- Fotokopje të diplomës së arsimit parauniversitar ose të arsimit të lartë të noterizuar dhe të vërtetuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale/Rrethit;
- Diplomë, dëshmi, certifikatë për aftësitë profesionale (nëse ka), të noterizuar;
- Dëshmi penaliteti;
- Vërtetim nga prokuroria;
- Vërtetim nga gjykata;
- Fletë të ekzaminimit mjekësor nga Spitali Ushtarak i FA në Komandën Mbështetëse.

b) Periudha e regjistrimit: 1 dhjetor 2014 deri më 14 janar 2015.

Adresa:
Qendra e Personel Rekrutimit, Rruga e "Dibrës"
(Ish-Shkolla e Bashkuar), Tiranë.
Kontakt:
++ 355 69 88 01 195

Në ANO, përfundoi Kursi i 31-të Bazë i nënoficerit

Në këtë kurs u përgatitën 43 kursantë, të cilët vinin nga komandat e Forcave dhe njësi të të tjera të Forcave tona të Armatosura

Në Akademinë e Nënoficerëve "Thomson" përfundoi Kursi Bazë i nënoficerit. Në këtë kurs, i cili shënon numrin 31 të kurseve të këtij lloji që janë realizuar në këtë akademi, morën pjesë dhe u përgatitën 43 kursantë, të cilët vinin nga Forcat dhe njësi të të tjera të Forcave tona të Armatosura. Kursi zgjati 12 javë dhe kursantët u trajnuan në rolin e komandantit të skuadrës, për marrjen e bazave të nënoficerit si lider dhe si drejtues skuadre.

Risi ishte se testimet për pjesëmarrjen në këtë kurs u zhvilluan nga komandat e njësive dhe reparteve, ku u përzgjodhën nënoficerë që plotësuan kriteret e përcaktuar për këtë qëllim.

Nga alternimi i programit prej gruplëndëve të formimit të përgjithshëm që zënë 76 orë, që synojnë krijimin e kritereve më të rëndësishme të përfaqësimit të personalitetit të tetarit, si dhe gruplëndëve të formimit profesional, që zënë 157 ore dhe synojnë krijimin e kritereve themelore të identifikimit të standardeve të tetarit si drejtues skuadre, njohës të fushave të përgatitjes, trajnimit dhe elementët e punës në grup.

Dy nga momentet kryesore të zhvillimit të fazës së përgjithshme të këtij kursi ishin modulet praktike të zhvilluara në terren për rreth 4 javë, të cilat më pas u kulmuan me stërvitjen komplekse 24 orëshe në rajonin e Regjimentit të Mbështetjes të Shtabit të Përgjithshëm "Selita 2014" dhe stërvitjen e zhvilluar për një javë në Qendrën e Simulimit me temë "Veprimet e skuadrës në Pikë Kontrolli". Qëllimi i kësaj stërvitje ishte planëzimi dhe aplikimi i Procedurave Standarde të Drejtimit të Trupave (PDT) në nivel skuadre, zhvillimi i stërvitjes dhe procesit të komandim-kontrollit në mjedis të simuluar në mënyrë reale. Aplikimi i këtij programi në këtë stërvitje i dha mundësinë kursantëve për një përfytyrim sa më real të një situate konkrete në terren, duke i bërë ata më kompetentë e të aftë në zgjidhjen e situatave reale nëpër misione.

Qëllimi i kësaj stërvitje ishte planëzimi dhe aplikimi i Procedurave Standarde të Drejtimit të Trupave (PDT) në nivel skuadre, zhvillimi i stërvitjes dhe procesit të komandim-kontrollit në mjedis të simuluar në mënyrë reale

Në përfundim të procesit kursantët iu nënshtruan testimeve përfundimtare, të cilat ishin:

Testim praktik, ku kursantët vepruan në rolin e drejtuesit të skuadrës dhe testimi intelektual, ku u vlerësuan njohuritë e tyre intelektuale dhe profesionale. Gjatë testimit rezultoi se grupi i mësimor i drejtuar nga instruktori rreshter Stilian Zhollanji u paraqit më mirë dhe arriti rezultate më të larta.

Në ceremoninë e zhvilluar me rastin e përfundimit të Kursit të 31-të Bazë mori pjesë komandanti i Akademisë së Nënoficerëve (ANO), kolonel Ndriçim Sallaku, përfaqësuesi i CUBIC në Qëndrën e Simulimit, z. Tony Darlington, si dhe i gjithë efektivi i akademisë. Komandanti i ANO-së, kolonel Ndriçim Sallaku shprehu vlerësime pozitive për punën e bërë nga ana e instruktorëve, stafit drejtues të ANO-së dhe veçanërisht kursantëve, të cilët përfunduan me sukses këtë kurs. Ai iu drejtua atyre se, dijet dhe informacioni i marrë nga instruktorët dhe leksionet e marra në ANO duhet të plotësohen vazhdimisht nëpërmjet literaturave të ndryshme, kjo pasi sot vetëzhvillimi është tepër i rëndësishëm për të qenë i suksesshëm e për të qëndruar të denjë përkrah homologëve të ushtrive të vendeve të tjera aleate. Njëkohësisht komandanti i ANO-së vlerësoi punën e bërë nga ana e Qendrës së Simulimit dhe palës amerikane nëpërmjet përfaqësuesve të CUBIC, për zhvillimin e stërvitjes me cilësi dhe sipas standardeve të NATO-s.

Në përfundim të ceremonisë u shpërndanë certifikata për kursantët më të dalluar.

Rreshtere Alketa Ktona Veshi